



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AFATI I KUSHTETUESES PO AFROHET, BLLOKADA NË KUVEND PO VAZHDON

FAQE 4-5



Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar as në herën e 48 pavarësisht se është duke u afruar 26 korriku, datë kjo e dhënë nga Gjykata Kushtetuese për funksionalizimin e institucionit legjislativ të

vendit. Vetëvendosja dhe ish-partitë opozitare janë duke e akuzuar njëra-tjetrën për bllokimin e Kuvendit. Deputetët e ish-opozitës e kanë akuzuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, se është duke punuar ditë e

natë kundër interesave të shtetit dhe se është duke i mbajtur peng institucionet. Madje ata kanë thënë se Kurti dhe disa deputetë të tij janë duke ushtruar kundërligjshëm edhe detyrën e ministrit

OPINION

**KOSOVA E DEGRADUAR NË
SY TË BOTËS DHE E BLLOKUAR
NGA BRENDA PREJ PARTIVE
TË SAJ POLITIKE** F. 6

Shkruan:
Hajdin ABAZI



AKTUALE



**HARADINAJ VIZITON FAMILJEN E
VEPRIMTARIT SALI BISLIMI,
VLERËSON ANGAZHIMIN E TIJ PËR
KOSOVËN: TË NGRIHET ZËRI EDHE
MË SHUMË PËR UÇK-NË** F. 6

**HAXHIU THOTË SE DO TA DËRGOJNË
NË KUSHTETUESE VENDIMIN E
SUPREMES: PËR MUA ËSHTË I
HABITSHËM** F. 5

**ISMAILI I PDK-së SHPALL
KANDIDATURËN PËR KRYETAR
TË PRISHTINËS** F. 6

EKONOMI



**EDHE FMN-ja E LARGON KOSOVËN
NGA LISTA E VENDEVE NË SITUATA
TË BRISHTA** F. 7

**PRANVERA KASTRATI EMËROHET
NË KRYE TË SEKRETARIATIT TË
CEFTA-s** F. 7



OSMANI: NË FILLIM TË JAVËS I DREJTOHEMI GJYKATËS KUSHTETUESE

F. 3

**KOŠOVA ARRESTON
NJË POLIC SERB
MË DYSHIME
PËR SPIUNAZH
PËR SERBINË** F. 6



**EKSPERTJA NË HAGË POHON
SE LITERATURA NJEH
MUNDËSINË QË VIKTIMAT T'I
EKZAGJEROJNË SIMPTOMAT
PËR ARSYE POLITIKE DHE
PERSONALE** F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Senati e kalon planin e Trumpit për shkurtimin e ndihmave amerikane në botë në vlerë 9 miliardë dollarë

UASHINGTON, 17 KORRIK - Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) e ka miratuar të enjten planin e presidentit Donald Trump për shkurtime në vlerë 9 miliardë dollarë për financimin e ndihmave amerikane në botë dhe transmetuesve publikë, duke i dhënë presidentit republikan një tjetër fitore. Me 51 vota për dhe 48 kundër, senatorët e kaluan kërkesën e Trumpit për shkurtime në vlerë prej 9 miliardë dollarësh nga shpenzimet tashmë të miratuara nga Kongresi. Shumica e shkurtimeve janë për programe që ndihmojnë vendet e huaja për t'i luftuar sëmundjet, luftërat dhe fatkeqësitë natyrore. Plani, gjithashtu, ndalon plotësisht 1.1 miliardë dollarë që Korporata për Transmetimet Publike do t'i merrte gjatë dy vjetëve të ardhshme. Trumpi dhe shumë nga republikanët e tjerë argumentojnë se shpenzimet për transmetimet publike janë të panevojshme dhe e kritikojnë mbulimin e lajmeve të tyre si të njëanshëm.

Paketa të veçanta për anulime të fondeve nuk kanë kaluar prej dekadash, pasi ligjvënësit kanë hezitur ta dorëzojnë kontrollin kushtetues mbi shpenzimet. Por, republikanët e Trumpit, të cilët kanë shumicë të ngushtë në Senat dhe në Dhomën e Përfaqësuesve, kanë treguar pak dëshirë për t'i kundërshtuar politikën e tij që nga fillimi i mandatit të dytë në janar. Nëntë miliardë dollarë në fjalë përfaqësojnë një shumë goxha të vogël në krahasim me buxhetin federal prej 6.8 trilionë dollarësh, dhe janë vetëm një pjesë e vogël e fondeve të miratuara nga Kongresi që administrata Trump ka mbajtur pezull teksa synon shkurtime të mëdha, shumë prej të cilave të urdhëruara nga Departamenti për Efikasitetin Qeveritar (DOGE) i drejtuar nga miliarderi Elon Musk. Sipas ligjvënësve demokratë, deri në mesin e qershorit Trumpi kishte bllokuar 425 miliardë dollarë financime të miratuara më parë nga Kongresi.



Megjithatë, Trumpi dhe mbështetësit e tij kanë premtuar më shumë kërkesa për “anulim fondesh”, në përpjekje për ta tkurrur qeverinë federale. Dhoma e Përfaqësuesve ka miratuar legjislacionin për anulimin e fondeve muajin e kaluar me 214 vota për dhe 212 kundër, pa ndryshuar kërkesën e Trumpit. Katër republikanë iu bashkuan 208 demokratëve për të votuar

kundër. Por, pasi disa senatorë republikanë kanë shprehur shqetësim për shkurtime në programet globale shëndetësore, drejtori i Zyrës për Menaxhimin dhe Buxhetin, Russell Vought, tha të martën se PEPFAR, një program global për luftën kundër HIV/AIDS-it, i nisur në vitin 2003 nga presidenti George W. Bush, do të përjashtohet nga shkurtime. Ky ndryshim e ka ulur shumën

e shkurtimeve nga 9.4 miliardë në 9 miliardë dollarë, gjë që kërkon një votim tjetër në Dhomën e Përfaqësuesve para se masa të dërgohet në Shtëpinë e Bardhë për nënshkrimin e Trumpit. Anulimet e fondeve duhet të miratohen deri sot (e premte). Përndryshe, kërkesa do të skadojë dhe Shtëpia e Bardhë do të detyrohet t'i ndjekë planet e shpenzimeve të miratuara nga Kongresi. Dy nga 53 senatorët republikanë, Lisa Murkowski nga Alaska dhe Susan Collins nga Maine, u janë bashkuar demokratëve në votimin kundër legjislacionit. “Nuk ke pse të shkatërrosh të gjithë Korporatën për Transmetimet Publike”, ka thënë Murkowski në një fjalim në Senat. Ajo ka shtuar se administrata Trump nuk kishte dhënë garanci që lufta kundër sëmundjeve si malaria dhe poliomieliti në mbarë botën do të vazhdojë. Mbi të gjitha, Murkowski ka thënë se Kongresi duhet ta ruajë rolin e tij në vendosjen e mënyrës se si shpenzohen fondet federale.

NATO: Transferimi i ‘Patriotëve’ në Ukrainë është duke u përgatitur



BRUKSEL, 17 KORRIK - Kryekomandanti i NATO-s, Alexis Grynkewich, ka thënë të enjten se përgatitjet sa i përket transferimit të shpejtë të sistemeve të mbrojtjes ajrore “Patriot” për në Ukrainë janë në zhvillim e sipër gjersa vendi po përballë me disa prej sulmeve më të rënda të Rusisë që prej fillimit të luftës, raporton “Reuters”. “Përgatitjet janë në zhvillim e sipër, ne po punojmë ngushtë me gjermanët për transferimin e ‘Patriotëve’”, ka thënë ai në

një konferencë në qytetin gjerman të Wiesbadenit. “Udhëzimi që më është dhënë ka qenë që të lëvizim sa më shpejt të jetë e mundur”, ka thënë ai. Të hënën presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar se një vend i paidentifikuar ishte gati të siguronte menjëherë 17 sisteme “Patriot” për Ukrainën. Sipas raportimeve, besohet se Ukraina zotëron të paktën gjashtë “bateri” funksionale të mbrojtjes ajrore “Patriot”, sistem ky i bazuar në

kamionë që përfshijnë radarë dhe raketahedhës. Disa vende evropiane kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të blerë armë amerikane për Ukrainën në kuadër të planit të parashtruar nga Trumpi. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka njoftuar disa ditë më parë se shtetet si Gjermania, Finlanda, Kanada, Norvegjia, Suedia, Britania e Madhe dhe Danimarka do të jenë ndër blerësit kryesorë që do ta furnizojnë Kievin zyrtar.

Yulia Svyrydenko emërohet kryeministre e Ukrainës

KIEV, 17 KORRIK - Kuvendi i Ukrainës e ka emëruar Yulia Svyrydenkon kryeministre të vendit në kuadër të riformatimit më të madh të kabinetit qeveritar në këtë shtet në vjetët e fundit, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit në periudhë lufte. Svyrydenko, 39-vjeçare, e ka marrë detyrën nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, me kërkesë për rritje të prodhimit të brendshëm të armëve dhe ringjallje të

ekonomisë së Ukrainës, të varur në mënyrë të konsiderueshme nga kreditë. Në fjalimin para Kuvendit, Zelensky ka thënë se pret që qeveria ta rrisë numrin e armëve që prodhohen brenda territorit dhe që brenda gjashtë muajve ato jenë të shpërndara në fushëbetejë të 50 për qind e ushtarëve. Ai e ka përmendur edhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik me aleatët si një prej synimeve kryesore të riformatimit më të

madh qeveritar prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë më 2022. Svyrydenko është teknokrate me përvojë, e cila ka shërbyer si zëvendëskryeministria e parë e Ukrainës prej vitit 2021. Ajo është zotuar se do të veprojë “me shpejtësi dhe vendosmëri”. “Lufta nuk lë hapësirë për vonesa”, ka thënë ajo përmes një postimi në “X”. “Prioritetet tona për gjashtë muajt e parë janë të qarta: furnizime të qëndrueshme për

ushtinë, zgjerim të prodhimit të brendshëm të armëve dhe përf forcim të kapaciteteve teknologjike për forcat tona mbrojtëse”. Svyrydenko është e njohur brenda qarqeve të administratës amerikane, pasi ajo e ka negociuar marrëveshjen për qasjen e Shteteve të Bashkuara në mineralet e rralla të Ukrainës. Këto negociata konsiderohen kryesore në përf forcim të marrëdhënieve në mes të Kievit



dhe Uashingtonit. Duke iu adresuar ligjvënësve të enjten, Zelensky ka thënë se do të ketë edhe marrëveshje të tjera që do të arrihen me ShBA-në.

EKSPERTJA NË HAGË POHON SE LITERATURA NJEH MUNDËSINË QË VIKTIMAT T’I EKZAGJEROJNË SIMPTOMAT PËR ARSYE POLITIKE DHE PERSONALE

HAGË, 17 KORRIK - Ekspertja mjeko-ligjore, Karin Duhne-Prinsen, gjatë dëshmisë të mërkurën në gjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka pohuar se Protokollit i Stambollit e njeh mundësinë e ekzagjerimit të simptomave të një personi për arsye personale ose politike. Duhne-Prinsen e ka pohuar këtë gjë duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga avokati i Jakup Krasniqit, Victor Baieshu.

Pas avokatit, pyetje për dëshmitaret nuk kanë pasur palët e tjera, por me pyetje ka vazhduar trupi gjykues. Pas përfundimit të pyetjeve nga ta, këto dëshmitare kanë përfunduar dëshminë e tyre dhe me këtë ka përfunduar paraqitja e provave gojore nga ana e mbrojtësit të viktimave. Ekspertja gjatë seancës është pyetur nëse një kërkesë për azil mund të jetë një prej arsyeve personale që mund ta bëjnë një person që të shpikë ose ekzagjerojë simptomat. “Është si mundësi, mund të jetë një

prej arsyeve”, ka thënë Duhne-Prinsen.

Avokati i Krasniqit ka pyetur nëse ekspertja ishte në dijeni të faktit se nga periudha 1989 deri më 1999-n të paktën 350 mijë shqiptarë etnikë janë larguar nga Kosova dhe kanë kërkuar azil në Evropën Perëndimore, duke përfshirë edhe shqiptarë që kanë pretenduar se janë kosovarë.

Duhne-Prinsen ka pohuar se ka njohuri se shumë shqiptarë etnikë janë larguar nga Kosova gjatë kësaj periudhe.

Avokati i Krasniqit ka pyetur se duke marrë parasysh kontekstin, metodologjia e përdorur nga ekspertët a ka përfshirë hapa për të kuptuar në qoftë se viktimat në këtë rast kanë bërë kërkesa të vazhdueshme për azil ose në qoftë se kanë ndonjë konstatim të besueshëm sa i takon procesit të migracionit. Pra, ai ka pyetur nëse kanë analizuar historikun e azilit të personave që i kanë vlerësuar si pjesë e raportit. “Jo, nuk jemi marrë fare me këtë. Thjesht u kemi dhënë përgjigje pyetjeve që na u



bënë”, ka thënë Duhne-Prinsen, raporton “Betimi për Drejtësi”. Duhne-Prinsen ka pohuar se raporti i tyre mbështetet vetëm në simptoma që janë raportuar në dëshmitë e viktimave dhe nuk është bërë verifikim i kontekstit të viktimave. Ajo ka thënë se nuk është puna e tyre që t’u japin vlerë juridike

simptomave. Ekspertja, po ashtu, është pyetur nëse metodologjia e përdorur nga ato mund të bëjë dallim në mes një traume të përgjithshme dhe simptomave që janë të ekzagjeruar ose shpikura. “Në ekzaminimet ligjore që ne kryejmë, të cilat janë të ndryshme nga akt-ekspertiza,

në rastin e parë, ne mund ta bëjmë këtë gjë..., por unë nuk mund ta di dot në qoftë se personi e ka zmadhuar apo e ka sajuar në mendjen e vet, sepse nuk i kemi bërë ekzaminim mjekësor. Për këtë akt-ekspertizë në fjalë, nuk mund të them gjë tjetër”, ka thënë ajo. Victor Baieshu ka pyetur se nëse një prej vështirësive që haset në hartimin e një raporti të tillë është mungesa e aftësisë për identifikim nëse simptomat zmadhohen për përfitime si kërkesa për azil. “Mendoj se kjo është diçka që shkon përtej fushëveprimit të këtij raporti. Nuk e bëjmë dot këtë vlerësim ne. Ju iu referuat Protokollit të Stambollit dhe e kemi shpjeguar disa herë se Protokollit i Stambollit është një udhëzim për ekzaminimet mjekësore, ndërkohë që raporti i prillit 2025 nuk është një raport i tillë. Në akt-ekspertizën tonë ne jemi të qartë, por fabrikimi ose shpikja e simptomave është diçka që duhet ta kenë parasysh profesionistët”, ka thënë Catherine Nicola-Black.

NDRYSHJE NGA THAÇI DHE KRASNIQI, VESELI DHE SELIMI S’DO TË THËRRASIN DËSHMITARË

HAGË, 17 KORRIK - Pasi u është rrëzuar mocioni sipas Rregullës 130 që parashihet kërkesë për rrëzimin e një apo disa akuzave në aktakuzë, mbrojtja e Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit kanë njoftuar se nuk do të thërrasin dëshmitarë.

Ndryshe nga Selimi dhe Veseli, Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi ka bërë me dije se ata do të thërrasin dëshmitarë, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Katër ekipet e mbrojtjes e kanë njoftuar trupin gjykues për qëndrimet e tyre më 16 korrik 2025. “Në përputhje me Urdhrin e Panelit Gjyqësor dhe në pajtim me Rregullën 119 (1) të rregullave, mbrojtja për z. Hashim Thaçi (‘mbrojtja’) njofton për qëllimin e saj për të paraqitur një çështje të mbrojtjes”, thuhet në parashtrimin e mbrojtjes së Thaçit, ngjashëm edhe në atë të Krasniqit.

Kurse në parashtrimin e tyre, Veseli dhe Selimi kanë treguar se kanë hequr dorë nga kjo e drejtë e tyre. “Mbrojtja njofton këtu



panelin dhe prokurorinë se nuk ka ndërmend të paraqesë një çështje të mbrojtjes, dhe se z. Veseli nuk ka ndërmend të japë dëshmi në mbrojtjen e tij...Prandaj, në përputhje me Rregullën 119 (1) dhe urdhrin e panelit gjyqësor, mbrojtja për z. Selimi njofton se nuk ka ndërmend të paraqesë një çështje të Mbrojtjes”, është thënë në dy parashtrimet e dorëzuara ndaras nga mbrojtja e Selimit dhe e

Veselit.

Trupi gjykues në këtë çështje më 16 korrik 2025 ka marrë vendim për ta rrëzuar në tërësi mocionin e mbrojtjes lidhur me rrëzimin e disa fakteve materiale që kanë të bëjnë me akuzat në aktakuzë që lidhen me ngjarje që kanë ndodhur para majit të 1998-s dhe pas 20 qershorit të 1999-s në rastin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi. “Trupi

gjykues vëren se incidentet dhe ngjarjet që kanë ndodhur në kohën që kundërshtohen prej mbrojtjes nuk janë akuza brenda kuptimit të Rregullës 130”, tha kryetari i trupit gjykues Charles Smith III.

Ndërkohë, më 15 prill 2025, prokuroria ka njoftuar se ka përfunduar paraqitjen e provave në këtë rast.

Zyra e Prokurorit të Specializuar më 30 shtator 2022 ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me akuza, ku këta të fundit ngarkohen kinse për krime lufte e krime kundër njerëzimit.

Më 29 prill 2022 Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, ku pretendohet se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë e Semetistë.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Ata kanë bërë disa herë kërkesa për lirim me kusht, por nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Speciale.

Që nga fillimi i procesit gjyqësor janë larguar disa nga avokatët kryesorë për shkak të çështjeve financiare. Për këtë çështje janë kritikuar ashpër institucionet e Kosovës të cilat që nga fillimi i këtij procesi gjyqësor janë duke u drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

Sllavisha Filiq dënohet me 15 vjet burgim për zhdukjen e doktorit Hafir Shala

PRISHTINË, 17 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 15 vjet burgim të akuzuarin për krime lufte, Sllavisha Filiq.

Aktgjykimi është shpallur të enjten nga kryetarja e trupit

gjykues, Violeta Namani-Hajra. Sllavisha Filiq ngarkohet se si pjesëtar i Sigurimit Shtetëror të Serbisë, së bashku me dy zyrtarë të tjerë, e kishin dërguar në objektin e Sigurimit Shtetëror në Prishtinë mjekun Hafir

Shala, ku u ishte nënshtruar rrahjeve dhe torturave dhe se që nga ajo ditë më nuk dihet për fatin e tij. Gjykatësja Namani-Hajra ka thënë se dënimi me burgim do të ekzekutohet kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.



Osmani: Në fillim të javës i drejtohem Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 17 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka paralajmëruar se nëse nuk ka konstituim të Kuvendit deri në fundjavë, atëherë në fillim të javës do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. "Jemi duke përgatitur lëndën për gjykatë kushtetuese, dhe nëse edhe gjatë këtij vikendi nuk ka marrëveshje me

konstituim, atëherë në fillim të javës do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese. Mund të marrë shumë kohë, e kjo na fut në krizë kushtetuese me të cilën nuk jemi përballur asnjëherë", ka thënë Osmani në një konferencë për medie pas vizitës zyrtare në ShBA dhe Letoni. Ndërsa duke komentuar

deklaratat e presidentit amerikan, Donald Trump dhe reagimin e të dërguarit të presidentit amerikan për Misionin të Posaçme, Richard Grenell, Osmani ka thënë se Serbia ka pasur qëllim dhe ka ende qëllim destabilizimin e situatës së sigursë në Kosovë, dhe se këtë vlerësim që e ka bërë edhe në Uashington ditë më

parë, e ka bazuar në informatat e vazhdueshme që i ka marrë nga institucionet e sigursë të Republikës së Kosovës. "Më konkretisht në fund të muajit maj kemi marrë informacione specifike lidhur me veprimet e Serbisë në kufi me Kosovën. Menjëherë pas marrjes së këtyre informacioneve kam pasur takime me institucionet e



sigursë të cilat më raportojnë si presidente. Jemi siguruar që çdo institucion në Kosovë ka mobilizim të duhur për mbrojtje të vendit", ka thënë ajo.



AFATI I KUSHTETUESES PO AFROHET, BLLOKADA NË KUVEND PO VAZHDON

Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar as në herën e 48 pavarësisht se është duke u afuar 26 korriku, datë kjo e dhënë nga Gjykata Kushtetuese për funksionalizimin e institucionit legjislativ të vendit. Vetëvendosja dhe ish-partitë opozitare janë duke e akuzuar njëra-tjetrën për bllokimin e Kuvendit. Deputetët e ish-opozitës e kanë akuzuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, se është duke punuar ditë e natë kundër interesave të shtetit dhe se është duke i mbajtur peng institucionet. Madje ata kanë thënë se Kurti dhe disa deputetë të tij janë duke ushtruar kundërligjshëm edhe detyrën e ministrit

nevojshme për të qeverisur e vetme në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Vetëvendosja ka dalë e para duke i fituar 48 ulëse, 13 më pak se të paktën 61 të nevojshme për ta formuar qeverinë e re e vetme. PDK-ja ka zënë vendin e dytë me 24 ulëse, LDK-ja e treta me 20, AAK-Nisma 8 dhe Lista Serbe 9.

respektojnë aktgjykimin e Supremes, duke i liruar menjëherë funksionet ekzekutive për t'ua deleguar ato zëvendësve të tyre", ka thënë deputeti Krasniqi.

Bajrami: Kurti ditë e natë punon kundër demokracisë dhe rendit kushtetues të Kosovës

Krasniqi: Kurti dhe të tjerët t'i lirojnë menjëherë funksionet ekzekutive

Altin Krasniqi, deputet i Partisë Demokratike të Kosovës, ka thënë se Gjykata Supreme e ka vulosur të vërtetën që kjo parti e ka theksuar nga dita e parë, se mbajtja e funksioneve të dyfishta është e kundërligjshme dhe jokushtetuese. Krasniqi nga foltorja e Kuvendit, pas ndërprerjes së seancës konstituive, i ka bërë thirrje Kurtit dhe ministrave në detyrë, që janë edhe deputetë, t'i lirojnë "menjëherë funksionet ekzekutive". "Gjykata ka vulosur një të vërtetë që ne e kemi theksuar që nga dita e parë. Mbajtja e funksioneve të dyfishta është e kundërligjshme dhe jokushtetuese. Kjo është arsyeja që në seancën e parë kemi kundërshtuar raportin për verifikimin e mandateve të deputetëve. PDK-ja i bën thirrje kryeministrit në detyrë, Albin Kurti dhe ministrave që janë njëkohësisht deputetë, ta

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka kritikuar ashpër kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, duke thënë se ky i fundit mbështillet me flamurin kuq e zi për ta mbuluar korrupsionin porse, sipas saj, korrupsioni nuk mbulohet më. Ajo e ka akuzuar Kurtin duke thënë se ky i fundit punon kundër shtetit të Kosovës, të cilin nuk e ka njohur as më herët. Bajrami ka deklaruar se Kurti e ka bërë shtetin e Kosovës si "tavolinë suedeze", duke sulmuar e duke mos njohur atë çka nuk i shkon përshtati atij. "Albin Kurti mbështillet me flamurin kuq e zi për ta mbuluar korrupsionin, por korrupsioni nuk mbulohet më. Albin Kurti po punon kundër shtetit të Kosovës çdo ditë. Ai nuk e ka njohur as më herët shtetin e Kosovës, e që katër vjet e gjysmë në pushtet, ai e ka bërë shtetin e Kosovës si tavolinë suedeze. Ai e njeh atë çka i konvenon dhe nuk njeh dhe e

EPOKA E RE **Lirim GECI**

PRISHTINË, 17 KORRIK - Deputetët e zgjedhur kanë dështuar ta bëjnë Kuvendin e ri të Kosovës edhe në tentimin e së enjtes pavarësisht se po përfundon afati i dhënë nga Gjykata Kushtetuese për formimin e institucionit ligjvënës më së largu deri më 26 korrik. Kjo ishte hera e 48 që deputetët janë mbledhur, çdo të dytën ditë që nga 15 prilli, dhe kanë dështuar ta përmbushin detyrimin kushtetues. Në seancën e së enjtes ka munguar deputeti Albin Kurti, i cili është thënë se ndodhet në Greqi. Edhe në këtë mbledhje PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja dhe Lista Serbe kanë refuzuar t'i propozojnë anëtarët për komisionin që duhet ta organizojë votimin e fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit. Ata janë duke e konsideruar këtë procedurë të papajtueshme me Kushtetutën dhe e kanë kundërshtuar vazhdimisht.

Lëvizja Vetëvendosje, fituese e zgjedhjeve parlamentare të shkurtit, është duke insistuar se votimi i fshehtë është në përputhje me ligjin dhe po kërkon që procesi të mos bllokohet më tej. Emërimi i kandidates së saj, Albulena Haxhiu, për kryetare të Kuvendit, është hedhur disa herë në votim të hapur, por nuk ka marrë mbështetjen e nevojshme, pasi opozita ka votuar kundër. Në seancën e 17 korrikut, kryesuesi Avni Dehari ua ka ndërprerë fjalën deputetëve të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së të cilët nisën ta adresonin problemin e ngërçit. Seanca ka dështuar dhe vazhdimi i radhës do të mbahet më 19 korrik. Ndërkohë, më 26 qershor, Gjykata Kushtetuese ka vendosur që Kuvendi duhet të konstituohet brenda një afati 30-ditor, pa sqaruar pasojat nëse ky afat nuk respektohet. Kjo ka hapur rrugë për interpretime të ndryshme nga partitë politike të cilat mbeten të ndara në qasjen e

tyre ndaj zgjidhjes së situatës. Javën e parë të korrikut, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e partive politike, me synimin për të gjetur një rrugëdalje nga bllokada institucionale. Pas përfundimit të konsultimeve, ajo ka theksuar se konstituimi i Kuvendit brenda afatit 30-ditor, të vendosur nga Kushtetuesja, nuk është çështje vullneti, por obligim kushtetues. Osmani u ka bërë thirrje partive të angazhohen seriozisht për të gjetur një zgjidhje sa më parë. Këshilltari i saj për medie, Bekim Kupina, ka thënë se presidentja po shqyrton mundësitë ligjore për t'i drejtuar një kërkesë sqaruese Gjykatës Kushtetuese me qëllim që të kuptohen pasojat juridike në rast se Kuvendi nuk konstituohet brenda afatit të dhënë. Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re. Ngërçi vjen pasi asnjëra parti nuk e ka fituar shumicën e

Osmani dhe Prattipati bisedojnë për hapat e konstituimit të Kuvendit dhe sigurinë

PRISHTINË, 17 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim të ngarkuarën me punë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Anu Prattipati. Gjatë takimit është diskutuar për vizitën e fundit të presidentes Osmani në ShBA, takimet e shkëlqyeshme të

zhvilluara me zyrtarë të lartë të administratës Trump si dhe për çështje të tjera me interes të përbashkët. Me këtë rast, presidentja Osmani ka rikonfirmuar përkushtimin e Kosovës për avancimin e mëtejshmë të marrëdhënieve bilaterale, përfshirë hapjen e kapitujve të rinj të bashkëpunimit me

ShBA-në, me theks të veçantë në fushat e ekonomisë dhe të mbrojtjes. Në takim është diskutuar edhe për zhvillimet e fundit në vend, me fokus në hapat e mëtejshmë drejt konstituimit të Kuvendit në dritën e vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese si dhe për zhvillimet në fushën e sigurisë.



sulmon atë çka nuk i shkon përshtati atij”, ka thënë Bajrami. Më tutje, ajo ka theksuar se 16 deputetë nga grupi parlamentar i Vetëvendosjes, pas dështimit të seancës konstituive, kanë shkuar në zyrat e qeverisë dhe i kanë “uzurpuar ato zyra”. Bajrami ka kërkuar bashkim nga të gjithë për të mos e toleruar më këtë situatë. “A e keni parë qysh justifikohet për xhipat e zi, qysh justifikohet për truprojat, për qindra asistentë e këshilltarë që i ka, por Albin Kurti nuk i njeh vendimet e Gjykatës Supreme. 16 deputetë nga grupi i LV-së e lëshuan sallën këtu dhe shkuan në zyrat e qeverisë. I uzurpojnë ato zyra. Ata nuk e njohin rendin kushtetues dhe kjo është kampanë për alarm. Albin Kurti ditë e natë po punon kundër demokracisë, kundër institucioneve dhe kundër rendit kushtetues të këtij shteti. Unë singërisht po u bëj thirrje të gjithëve t’i bashkojmë forcat që këtë të mos e tolerojmë më”, ka thënë Bajrami.

Haradianj: Kurti me vetëdije po e mban pengë këtë situatë

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka bërë me dije se e gjithë Kosova është lodhur me situatën e bllokadës në Kuvend. Ai ka thënë se përgjegjës për këtë situatë është kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti. Sipas tij, ai po e mban Kosovën peng. “Mendoj që krejt Kosova është lodhur me këtë situatë. Ne po i përsërisim fjalët e njëjta. Kemi dhënë një ofertë dhe jemi të gatshëm të votojmë në rast se do të kemi një ndryshim të emrit të kandidatës. Nëse jo, të mbesim kështu, fatkeqësisht, edhe për një kohë. Unë besoj që me vetëdije z. Kurti është duke e mbajtur këtë situatë peng”, ka thënë Haradinaj.

Nisma paralajmëron marrëveshje të mundshme me LV-në

Pas dështimit të 48 më radhë, deputetja e Nismës Socialdemokrate, Xhevahire Izmaku, ka thënë se pret që kryetari i partisë, Fatmir Limaj, të takohet me liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për një marrëveshje të mundshme në fundjavë. “Presim që në fundjavë të ketë një epilog pozitiv. Shpresojmë se këto bisedime që kanë vazhduar me muaj të tërë, të prodhojnë rezultat dhe Kosova të ketë institucione”, ka thënë Izmaku për gazetarë. Ajo ka theksuar se çështja e bisedimeve është që Limaj të jetë kandidat për kryetar të Kuvendit, duke shtuar se “më në fund dikush po del mbi egot personale dhe partiake, e ky duket që do të jetë zoti Limaj pra, sepse nga fillimi e ka ndryshuar diskursin në këtë vend”. Edhe kandidatja e LV-së për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se do të ketë takime me Nismën për të diskutuar mundësinë e një marrëveshjeje për bashkëqeverisjeje. “Do të ndodhin takime dhe pas tyre do ta njoftojmë publikun përmes medieve nëse arrihet marrëveshje apo jo”, ka thënë Haxhiu, duke theksuar se qëndrimi i LV-së mbetet i qartë: “sipas Kushtetutës dhe dy aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, LV-së i takon propozimi për kryeparlamentar”.

48 DËSHTIMET E KUVENDIT, KOCI APLIKON NË LIBRIN E REKORDEVE GUINNESS: KJO NUK KA NDODHUR ASKUND NË BOTË

PRISHTINË, 17 KORRIK - Avokati Arianit Koci ka njoftuar se 48 dështimet për konstituimin e Kuvendit i ka adresuar edhe në librin e rekordeve Guinness. Ai ka treguar se ka aplikuar për regjistrimin e këtij rekordi në këtë libër. Koci ka shkruar në “Facebook” se një gjë e tillë nuk ka ndodhur askund në botë. “Aplikova në Librin e Rekordeve Guinness. Si qytetar i Kosovës, e paraqita rastin absurd që po ndodh në vendin tim: 48 herë rresht ka dështuar konstituimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Po, dyzet e tetë tentime dhe ende pa Kuvend funksional. Turp, turp, turp! Sipas meje, kjo nuk ka ndodhur askund në botë, as në vendet me krizë të thellë institucionale. Madje, as në shtetet me përçarje etnike,



sektare apo politike. Vetëm te ne, në një shtet që vetëquhet demokratik. Ky veprim është në vazhden e protestës sime qytetare, që kam nisur para Kuvendit”, ka shkruar ai, duke u shprehur optimist që Guinnessi do ta pranonte aplikimin e tij.

“Bllokimi i institucioneve tani është çështje e rendit demokratik, e të drejtave të qytetarëve dhe e funksionimit të shtetit. Nëse Guinness e pranon, të paktën ta dimë që jemi ‘të parët në botë’ për diçka, për një rekord turpi!”, ka shkruar Koci.

HAXHIU THOTË SE DO TA DËRGOJNË NË KUSHTETUESE VENDIMIN E SUPREMES: PËR MUA ËSHTË I HABITSHËM

PRISHTINË, 17 KORRIK - Ministrija në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se do të vazhdojnë të mbajnë mbledhje të qeverisë pavarësisht vendimit të Gjykatës Supreme e cila ka vlerësuar se nxjerrja e akteve nënligjore nga ministrit që janë njëkohësisht deputetë është e kundërligjshme dhe paraqet shkelje të dispozitave kushtetuese. “Po, do të vazhdojmë të mbajmë mbledhje të qeverisë, se jemi qeveri në detyrë. Shteti nuk mund të mbetet pa qeveri, të paktën tranzitore, pra që është në detyrë për t’i kryer obligimet që ka deri në zgjedhjen e qeverisë së re”, ka thënë ajo.

Haxhiu është pyetur edhe për



vendimin e Supremes, për të cilin ka thënë se do të dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese. “Në cilën faqe shkruan vendimi i Supremes që ne duhet t’i lirojmë (pozitat)? Unë nuk kam deklaruar për këtë, por për mua ka qenë një aktgjykim i habitshëm. Por meqë po më pyesni, për mua ka qenë një aktgjykim i habitshëm sepse, së pari, i ka tejkaluar kompetencat që ka. Ka hyrë në kompetencat e Kushtetueses. Ne do ta ankimojmë vendimin e Supremes sepse e kemi të drejtën e dërgimit në Gjykatë Kushtetuese, prandaj do t’i mbetet Gjykatës Kushtetuese ta bëjë vlerësimin për këtë”, ka thënë Haxhiu pas dështimit të 48 të konstituimit të Kuvendit.

Ushtarët amerikanë e ruajnë Kosovën edhe nga zjarret

PRISHTINË, 17 KORRIK - Ushtarët amerikanë po kujdesen që ta ndihmojnë Kosovën edhe në luftën kundër zjarreve. Trupat amerikane nga Garda

e Kentucky kanë ndihmuar në shuarjen e zjarreve të cilat kanë cenuar edhe trashëgiminë kulturore të Kosovës. Bëhet fjalë për manastirin e Deviçit i cili ndodhet në

Skenderaj. Për këtë ndihmesë të ushtrisë amerikane ka shkruar edhe Departamenti Amerikan i Mbrojtjes në faqen zyrtare në “X”. “Kur zjarret kërcënuan manastirin e

Deviçit në Kosovë, Garda e Kentakit, Task Forca e Aviacionit u vendos në aksion. Falë reagimit të tyre të shpejt, manastiri u ruajt”, ka shkruar Departamenti Amerikan i Shtetit.



ISMAILI I PDK-së SHPALL KANDIDATURËN PËR KRYETAR TË PRISHTINËS

PRISHTINË, 17 KORRIK - Uran Ismaili nga radhët e PDK-së edhe zyrtarisht ka shpallur kandidaturën për kryetar të Prishtinës në një formë krejt unike. Përmes një videoje të publikuar në rrjete sociale, Ismaili ka listuar një sërë arsyesh pse po rikandidon, këtë herë i bindur se Prishtina meriton më mirë dhe më shumë. Në videomesazhin e tij, Ismaili është shfaqur në pjesë të ndryshme të qytetit të Prishtinës duke përmendur se kandidatura e tij vjen nga përkushtimi personal që ka ndaj kryeqytetit dhe nga bindja se Prishtinës i duhet një drejtëm i ri. “Kur po më pyesin pse po kandidoj prapë, përgjigjja ime është e thjeshtë: Është qyteti im. Këtu jam rritur. Këtu jetoj.

Këtu është e ardhmja jonë. Na takon neve, qytetarëve të Prishtinës, të bëhemi bashkë për të. Nuk mundemi me pritë derisa të tjerët bëjnë eksperimente që e bllokojnë jetën në qytet”, ka thënë Ismaili, duke shtuar se për t’i shërbyer Prishtinës është nderi më i madh i jetës së tij. “Është koha për Prishtinën, e unë nuk e kam ndër mend të dorëzohem”, ka thënë Ismaili. Në ditën e zyrtarizimit të kandidaturës për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili ka paralajmëruar rihapjen e sheshit “Xhorxh Bush”. Sheshi “Xhorxh Bush” te Katedralja është mbyllur me arsyetimin për të ofruar një zgjidhje për trafikun në qytet. Megjithatë, prej asaj kohe nuk



është bërë asnjë investim konkret, ndërkohë që bllokimi i kësaj nyje të rëndësishme për kryeqytetin ka rezultuar në rritje

të ndjeshme të trafikut, pengesa në qarkullim dhe pakënaqësi nga qytetarët dhe bizneset përreth. “Prishtinës i duhen

zgjidhje konkrete dhe të shpejta për ta nxjerrë nga kaosi dhe ngecja. Ky është një nga ato vendime”, ka thënë Ismaili.

HARADINAJ VIZITON FAMILJEN E VEPRIMTARIT SALI BISLIMI, VLERËSON ANGAZHIMIN E TIJ PËR KOSOVËN: TË NGRIHET ZËRI EDHE MË SHUMË PËR UÇK-në



PRISHTINË, 17 KORRIK - Kryetari i AAK-së, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, ka vizituar familjen e Sali Bislimit nga fshati Topillë e Shtimes. Haradinaj gjatë kësaj vizite ka thënë se Sali Bislimi është ndër ata shqiptarë që edhe pse larg vendlindjes,

kurrë nuk i është ndarë shërbimit ndaj kombit dhe komunitetit tonë në mërgatë. Sipas tij, përkushtimi i Bislimit për çështjet kombëtare dhe angazhimi për shqiptarët në Zvicër janë shembull frymëzimi. “Pata nderin të qëndroj në

familjen e Sali Bislimit nga fshati Topillë e Shtimes, veprimtar i shquar në Zvicër. Saliu është ndër ata shqiptarë që edhe pse larg vendlindjes, kurrë nuk i është ndarë shërbimit ndaj kombit dhe komunitetit tonë në mërgatë. Përkushtimi i tij për çështjet kombëtare dhe angazhimi për shqiptarët në Zvicër, janë shembull frymëzimi. Mirënjohje për mikpritjen!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

E Sali Bislimi ka shkruar në “Facebook” se me një pritje vëllazërore pati kënaqësinë ta mirëpresë në odën e tij ish-kryeministrin Haradinaj. “Njeriun e historisë, në një ambient festiv në odën tonë të shoqëruar me shumë miq dhe familjarë”, ka shkruar Bislimi, duke shtuar se me këngët dhe debatet për Kosovën dhe shqiptarinë vazhduam deri vonë. “Të gjithë së bashku u dakorduam se duhet ngritur

zërin edhe me shumë për UÇK-në deri në qiell për t’i thënë botës se ne jemi këtu dhe nuk kemi atdhe tjetër do ta mbrojmë dhe zhvillojmë bashkë edhe me bijtë tanë më të mirë që gjinden padrejtësisht në Hagë. Faleminderit Ramush për të gjitha, na erdhe dhe na dëshmove respekt me shumë modesti, nder kombit, familjes shqiptare në traditat e vlerave Kastriotike”, ka shkruar Bislimi.



KOSOVA ARRESTON NJË POLIC SERB MBI DYSHIMET PËR SPIUNAZH PËR SERBINË

PRISHTINË, 17 KORRIK - Autoritetet e Kosovës kanë zhvilluar të enjten një aksion në lidhje me dyshimet për spiunazh, duke shtuar luftën kundër rrjetit të spiunazhit. Një polic është arrestuar në kuadër të këtij operacioni, ka bërë me dije ministri në detyrë i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, i cili ka thënë se “po çmontohen me sukses rrjetet e spiunazhit në Kosovë”. “Sot është arrestuar zyrtari policor, Bojan Jevtiq, nën dyshimin për veprimtari të kundërligjshme të

spiunazhit për llogari të strukturave të sigurisë së Serbisë”, ka shkruar Sveçla në “Facebook”. Ai ka thënë se “ky është i arrestuari i gjashtë me radhë për rastet e spiunazhit në Kosovë”. “Njëri nga të dyshuarit tashmë e ka pranuar fajësinë, duke konfirmuar seriozitetin, profesionalizmin e institucioneve si dhe përfshirjen e Serbisë në përpjekjet destabilizuese ndaj Republikës së Kosovës”, ka shkruar Sveçla. Ndërsa Prokuroria Speciale e

Kosovës ka njoftuar të enjten se aksioni është kryer në bashkëpunim me Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Së voni, autoritetet në Kosovë kanë arrestuar, akuzuar e gjykuar serbë e shqiptarë nën dyshimet se po spiunonin për shërbimet e inteligjencës së Serbisë. Në qershor gjykata në Prishtinë e ka dënua Aleksandër Vllajiqin me pesë vjet burgim, pasi ai ishte deklaruar fajtor për akuzat se ishte përfshirë në spiunazh si



anëtar i Agjencisë serbe të Inteligjencës dhe Sigurisë (BIA). Momentalisht, dy të dyshuar, Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi, janë duke u gjykuar për spiunazh për Serbinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ata janë deklaruar të

pafajshëm për akuzat se kishin dhënë informacione të BIA serbe për disa institucione të sigurisë në Kosovë, për UÇK-në dhe masakrën e Reçakut. Në Kosovë, spiunazhi përkufizohet aktivitetet sekret i mbledhjes, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit të ndjeshëm në një shtet, organizatë ose grup tjetër. Sipas Kodit Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet me të paktën pesë vjet burgim, nëse i dyshuari shpallet fajtor.

Pranvera Kastrati emërohet në krye të sekretariatit të CEFTA-s

PRISHTINË, 17 KORRIK - Pranvera Kastrati është emëruar zyrtarisht drejtoreshë e re e sekretariatit të CEFTA-s, e njohur si Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore. Ky vendim ka ardhur pas një procesi të gjatë dhe transparent përzgjedhjeje, udhëhequr nga Kosova në cilësinë e saj kryesuese e CEFTA-s për vitin 2025.

Ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, e cila ka kryesuar takimin special të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s përmes platformës elektronike, ka

njoftuar se vendimi për emërimin e Kastratit është miratuar me konsensus të plotë nga të gjitha palët pjesëmarrëse. Sipas Hajdarit, ky është një hap i rëndësishëm institucional për CEFTA-n dhe një sukses për Kosovën në skenën rajonale dhe evropiane. “Emërimi i znj. Kastrati u bë pas një procesi përzgjedhjeje të ndarë në tri faza - skanimi fillestar, intervistat dhe vlerësimi final në Bruksel me përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë dhe mbështetjen e Komisionit Evropian”, ka thënë Hajdari. Valentina Superti, drejtoreshë

për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, vlerësoi lart procesin dhe theksoi se ky emërim ishte në pritje që dy vjet. Ajo e ka përgëzuar Kosovën për transparencën dhe profesionalizmin e treguar gjatë procesit të përzgjedhjes. Emërimi i Pranvera Kastrati shihet si një moment i rëndësishëm për vazhdimësinë institucionale të CEFTA-s, veçanërisht në zbatimin e Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM2), që është pjesë kyçe e Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor.



EDHE FMN-ja E LARGON KOSOVËN NGA LISTA E VENDEVE NË SITUATA TË BRISHTA



PRISHTINË, 17 KORRIK - Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) e ka hequr Kosovën nga lista e Shteteve në Situata të Brishtë dhe Konflikti (FCS/FCV), duke njohur përparimet e vendit në stabilitetin makro-financiar dhe forcimin e institucioneve.

Ky vendim i rëndësishëm vjen pas një njoftimi të ngjashëm nga Banka Botërore, e cila, gjithashtu, e ka përjashtuar Kosovën nga kjo

kategori.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka përshëndetur këtë vendim, duke shprehur mirënjohje të thellë ndaj FMN-së dhe Bankës Botërore për njohjen e përpjekjeve të vazhdueshme të Kosovës për ta forcuar qëndrueshmërinë ekonomike dhe institucionale. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpreh mirënjohjen e thellë ndaj

FMN-së për këtë njohje të rëndësishme të progresit institucional dhe qëndrueshmërisë makro-financiare të Kosovës”, është thënë në njoftimin e BQK-së.

Vendimi pritet të ndikojë pozitivisht në besimin e investitorëve të huaj dhe në mundësitë e zhvillimit ekonomik të vendit, duke krijuar një klimë më të favorshme për investime

dhe rritje ekonomike.

Largimi nga kjo listë konsiderohet si një moment domethënës për Republikën e Kosovës, duke reflektuar përparimin e vendit në forcimin e qëndrueshmërisë institucionale, stabilitetit makroekonomik, qeverisjes financiare dhe sundimit të ligjit. Përfitimet kryesore nga largimi nga lista FCS janë: Përmirësimi i perceptimit ndërkombëtar për

stabilitetin institucional dhe ekonomik të Kosovës, rritja e besimit të investitorëve dhe ulja e vlerësimeve për rrezik financiar, qasja më e favorshme në financim zhvillimor dhe kapital privat dhe komplementimi i vlerësimit të parë të kredisë sovraane për Kosovën, që reflekton trendin pozitiv në qeverisje dhe ekonominë e vendit.

Ndahen mjetet për rimbursimin e 10-përqindëshit për të pensionuarit e vitit 2025

PRISHTINË, 17 KORRIK - Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka njoftuar se ka ndarë mjetet për rimbursimin e 10-përqindëshit për të pensionuarit e vitit 2025. Në njoftimin e FKPK-së është thënë se mjetet për rimbursimin e 10-përqindëshit për të pensionuarit e vitit 2025 janë në shumën prej 2 milionë e 995 mijë e 26 euro e 14 cent për 6905 persona, të cilët: këtë vit e arrijnë moshën

e pensionimit, pra janë të lindur në vitin 1960 ose kanë vdekur dhe kursimet e tyre janë tërhequr nga trashëgimtarët e tyre pas rimbursimit të vitit 2024. “Ky është viti i tretë që po vazhdon rimbursimi i 10 përqindëshit për kontribuuesit që i kishin të kursyera deri në 9.999.99 euro në llogarinë e FKPK-së në momentin e aplikimit për tërheqjen e parakohshme

(më 2020 dhe 2021). Për këtë, më 2024 ishin rimbursuar 1 milion e 873 mijë e 875 euro e 75 centë, ndërsa më 2023 ishin rimbursuar 5 milionë e 431 mijë e 49 euro e 56 cent”, ka njoftuar FKPK-ja.

Sipas këtij njoftimi, sa i përket rimbursimit për pjesëmarrësit e tjerë, në përputhje me ligjin aktual, procesi do të vazhdojë deri në vitin 2028.



KOSOVA E DEGRADUAR NË SY TË BOTËS DHE E BLOKUAR NGA BREND PREJ PARTIVE TË SAJ POLITIKE

Pozita - po, e bartë përgjegjësinë kryesore për këtë maskaradë me Republikën, por edhe opozita, duke mos u bashkuar, nuk e kryen misionin e vet ndaj Republikës e ndaj aleatëve perëndimorë



Shkruan: Hajdin ABAZI

Ajo që po ndodh në Kosovë pas zgjedhjeve nacionale të sivjetme mund ta kenë dëshiruar vetëm ata që kanë qenë kundër Pavarësisë dhe Shtetbërjes së Kosovës. E pabesueshme, por realitet. Dhe duket sikur askujt nuk po i bëhet vonë që shteti ynë po degradohet në sy të botës perëndimore, kurse nga brenda e bllokuar nga mos arritja e një kompromisi politik midis partive shqiptare. Po të mund të ngriheshin dëshmorët e rënë për çlirim e ta shihnin këtë gjendje do t'i ngrinin duart nga qielli e do të thoshin: "O Zot, janë në vete këta politikanë apo jo, atë që e arritëm me luftë, me mund e sakrifica kaq lehtë e papërgjegjshëm po e nëpërkëmbin! Medet, medet!"

Dëshpërimi shtrihet gjithandej. Në vend që shteti ynë të përforcohet nga viti 2021, t'i tejkalonte ato mangësi që ishim manifestuar dhe të ecte përpara, po ndodhë një regres gjithandej! Shteti ka dështuar t'i mbrojtë ish-krakerët e UÇK-së për shkak të hileve të Qeverisë Kurti, e cila mbështetjen e cunguar po e bën për shkak të inateve politike dhe nga frika se lirimi i tyre mundet t'ia kërcënojë pushtetin Kurtit! Madje vetë Kurti i akuzoi ish-krakerët e UÇK-s, sidomos Hashim Thaçin e Kadri Veselin, se ata e drejtojnë PDK nga burgu i Hagës - kaq larg shkon paranoja e tij

ndaj madhështisë së tyre si çlirimtarë! Nga viti 2021, gradualisht por pandalshëm, janë degraduar raportet e Kosovës me partnerët tanë kryesor e që janë edhe sponsorizues të Pavarësisë e të Shtetbërjes (e në instancë të fundit edhe mbrojtësit e kombit shqiptar) si Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Britaninë e Madhe, por po ashtu edhe me aleatët tanë perëndimor dhe jo vetëm. Madje, jo rrallë, janë bërë veprime me pasoja për KFOR-in, përgjegjësin kryesor Euro-Atlantik për sigurinë e Kosovës, për shkak të moskoordinimit. Kjo qeveri, në këndvështrimin tim, me politikën e saj të jashtme (me përjashtim të mbështetjes së Ukrainës dhe të Izraelit, por që as këto nuk qe në gjendje t'i kapitalizojë në interes të Republikës së Kosovës) në diskrepancë me aleatët dhe shpesh kundër udhëzimeve të tyre ka bërë më shumë punë në ftohjen e raporteve (deri në masa nga BE-ja) me aleatët tanë perëndimor se sa që ka mund të bëjë Serbia me diplomacinë e saj anti-Kosovë! Prej refuzimit të gazit natyror me Greqinë e që ishte projekt amerikan e deri te mospërfillja e sugjerimeve për koordinim me shtet mike dhe shpesh drejtpërdrejt me Uashingtonin – janë veprime që e kanë dëmtuar dhe vazhdojnë ta dëmtojnë Kosovën, duke treguar se kjo qeveri nuk ka vullnet

bashkëveprimi dhe koordinimi. Më shumë se kaq, nuk ka mundur të ëndërrtoj as vetë Serbia!

Dhe kjo qeveri e kolapsoi energjetikën e Kosovës! Kur inicoheshin projektet për termocentralin Kosova e Re, Kurti e pasuesit e tij e refuzonin atë në emër të ambientalizmit! E asgjë nuk bënë në këto pesë vite për ta përmirësuar gjendjen. Ajo që tashmë është bërë e dukshme në pesë vitet e sundimit të Kurtit është bërja publike e transaksioneve me kompani serbe, e që Qeveria Kurti i ka yshtur e mbështetur dhe, me aq sa po thuhet, të gjitha lidhjet çojnë te zyra e Kurtit si kryeministër. Kurti e kishte periudhën e art 5-vjeçare për ta treguar veten si burrështetar që vendin e ngre kualitativisht duke përmirësuar standardin e jetesës, krijuar kondita për kompanitë vendore që të zhvillohen, të rritet punësimi e të ndalet emigrimi, por asnjë nga këto nuk i bëri - dhe nëse nuk ka arritur për 5 vite ai nuk mund të ketë sukses as edhe po të sundonte edhe 50 vite!

E vetmja e arritur e sundimit të Kurtit është vendosja e veriut të vendin nën rendin policor. Por kjo më tepër është rezultat i tërheqjes politike të minoritet serb dhe të direktivave nga Beogradi. Secila qeveri ka mund

ta bëjë këtë para sundimit të Kurtit, por logjika ishte që zgjidhja të jetë politike e jo policore dhe kjo ishte dhe është edhe sugjerimi i përhershëm i SHBA, Britanisë së Madhe, Gjermanisë e tërë BE-se si dhe i NATO-s. Dhe unë e besoj paqen, bashkëjetesën dhe integrimin e njëmendtë të serbëve përmes politikës, në radhë të parë të çlirimit nga agresioni politik i Beogradit me shovinizëm ndaj tyre dhe nga hapat konkret të institucioneve tona për t'i inkurajuar me mirëbesim. E di se shumica e serbëve e duan integrimin dhe çlirimin nga kjo gjendje, por pengohen, shantazhohen e kërcënohen. Pse konsideroj se zgjidhja është politike? Sepse, në zgjedhjet e sivjetme komunale është e qartë (nëse nuk ndodhë ndonjë ndryshim i papritur i gjendjes) se Lista Serbe do t'i fitojë ato. Dhe, nëse Vuçiq do të jetë ende në pushtet, do të shihet se çfarë mashtrimi ishte sovraniteti në veri. Atëherë me legjitimitetin e votës qytetare pushtetarët e komunave me minoritetin serb do t'ia tregojnë dhëmbët Kurtit - dhe policia nuk mundet t'i detyrojë vendimet politike! Realisht, gjendja në veri mbahet nën kontroll vetëm falë KFOR-it, ku me lejen e tij, policia jonë ka dhënë kontribut me profesionalizëm duke demonstruar kapacitete institucionale e besa edhe të sakrificës e të flijimit!

Qysh me ardhjen në pushtet në vitin 2021, Kurti me qeverinë e tij, nisi rrëmihjen e gjithçkaje që ishte bërë nga pararendësit e tij. Filloi me shkarkimet e drejtorëve dhe drejtuesve të agjencive te pavarura, duke pretenduar çkapjen e shtetit nga pararendësit, e në të vërtetë duke i kapur ato vetë më brutalisht se askush më parë! Dhe nuk vonoi e nisën të shpërthenin aferat korruptive thuaja kudo. Tenderët njëburimor dhe të negociuar, në vend të transparencës, u bënë mekanizëm për abuzime dhe për gjakderdhje të njëmendtë financiare! Diçka që e kishte kritikuar se e bënin të tjerët, Kurti e Co. e shndërroi në një fenomen mbisundues. Kur në qeveritë e tjera zbulohesh ndonjë skandal, nuk di t'i ketë marrë guximin ndokush për t'i justifikuar e aq më pak për t'i mbrojtur ata e për t'i akuzuar organet kompetente. Kurse Kurti e Co. bënë të kundërtën, i kritikonin organet e rendit e të drejtësisë e jo abuzuesit. Për shembull, ju kujtohet afera me rezervat e miellit dhe akuzat se po zbulohen sekretet e shteti, e me këtë synohej te mbulohej afera korruptive! Ose, shembulli tjetër - RTK-ja. Ajo është vendosur nën sundimin e njerëzve të Kurtit, sa që gjithçka dirigjohet politikisht, përfshirë edhe seancat konstituive të Kuvendit të Republikës, të cilat

nuk transmetohen të plota por në mënyrë selektive sipas shijeve politike të pushtetit. Është e vërtetë se edhe më parë ka pasur ndikime nga pushtetet, por kaq hapur kapur e kaq e ngulfatur nuk ka qene asnjëherë RTK-ja ç’prejse është krijuar! Në policinë e Kosovës ndiqen e suspendohen ata që inicijonë zbulimin, hetimin e arrestimin për afera korruptive, sidomos po qe se të tillët janë të lidhur me pushtetin ose me partinë e Kurtit. Ju kujtohet se si u ankua ministri i policisë për arrestimet e fundit për kontrabandë me drogë, se nuk kishte qenë i njoftuar për këtë aksion të policisë! Që sikur la të nënkuptohej se po ta kishte ditur, mund të kishte ndërhyrë e ndoshta edhe të selektonte se kush të arrestohej e kush jo! Përndryshe, do ta përgëzonte policinë e që nuk e bëri. Dhe askush nuk skuqet për këto veprime që ngulfasin profesionalizmin dhe inkurajimin e policisë në luftën kundër krimit të organizuar!

Kurti e Co. gjatë qeverisjes së tyre thuaja i kanë kapur të gjitha segmentet që ju duheshin. Ato që ende nuk kanë arritur t’i kapin, si bizneset në shumicën dërrmuese, mediat dhe drejtësinë, ju kanë shpallë luftë të hapur. Duke qenë se në zgjedhjet e fundit ka shënuar rënie të dukshme sa të mos mund me e konstituua as Kuvendin e Republikës, ka nisur një hakmarrja ndaj bizneseve. Kurti edhe më parë i ka atakuar bizneset, por vitin e fundit sikur u zbut, duket se shpresonte t’ua hidhte e t’ua merrte votat. Që nga ardhja në pushtet, Kurti në vend se të stimulonte ato, i ka stigmatizuar! Madje edhe i kërcënon, shantazhon e etiketon - jo se i kanë ikur obligimeve ndaj shtetit, por sepse thjesht nuk e mbështetin Kurtin. Motivet janë politike e jo ligjore. Dhe duken groteske pozitat herë patriotike e herë socialiste prej të cilave i atakon bizneset e Kosovës. Kurse bizneset serbe, edhe kur rrënjët e tyre çojnë në Beograd e Rusi, nuk e pengojnë pushtetin, sepse janë njerëz të tyre të involvuar. Shumë më e hapur është lufta kundër mediave, sidomos atyre që janë kritike dhe që denoncojnë skandale, abuzime e afera korruptive. Portale e gazetarë që kanë guximin profesional dhe qytetar të kryejnë misionin e tyre ndaj publikut, duke publikuar korrupsionin. kurdisjet dhe kapjen e shtetit hap pas hapi, etiketohen, ata kërcënohen e shantazhohen vetëm e vetëm që t’i bëjnë të heshtin. Por nuk ia ka arritur deri më tash, dhe gazetaria shqiptare e Kosovës është në linjën e parë të rezistencës kundër stërkeqjes së rendit demokratik e shndërrimin gradual thuaja në një diktaturë të hapur. Ajo realisht i ka dhënë goditjet më të fuqishme sundimit me autokraci të kamufluar të Kurtit e Co., dhe duke mbrojtur transparencën e duke i treguar

opinionit të gjerë se çfarë abuzimesh po bëhen nga Kurti e Co. në sundimin që kanë vendosur. Pa mediat tona shteti ynë do të ishte ngulfatur, demokracia do të ishte konvertuar në autokraci shumë më të hapur! Dhe shtylla tjetër e rezistencës ishte dhe vazhdon të jetë drejtësia. Gjyqësia dhe prokuroria po përpiqen t’i kryejnë obligimet e veta kushtetuese, për të ndjekur shkeljet, abuzimet, skandalet dhe mospërfilljet ligjore. Me gjithë se ka telashe jo të pakta të brendshme e që duhet gjithsesi të korrektohen, institucionet e drejtësisë kanë arritur, me gjithë pengesat nga Kurti e qeveria e tij, te veprojnë kundër krimit dhe abuzimit nga pushteti, këtë të fundit jo me përmasat dhe intensitetin e duhur për shkak të pengesave nga pushteti. Arritjen më të madhe gjyqësia dhe prokuroria e ka shënuar në mos nënshtrimin ndaj frymës autokratike të Kurtit për anashkalim të ligjit dhe për veprime me motive politike. Ndonëse janë futur aty-këtu edhe kuadro që janë të gatshëm ta bëjnë vullnetin e Kurtit më të zbatueshëm se ligji, në tërësi këto institucione e kanë ruajtur ende mëvetësinë. Dhe me këtë janë bërë mbrojtës të shtetit ligjor dhe të veprimeve bazuar në ligjshmëri, ani se qeveria Kurti i stimulon në të kundërtën. Kështu, mediat, gjyqësia e prokuroria si dhe kushtetuesja - kanë rezistuar të mos i nënshtrohen diktatit politik, po të mbështeten në përgjegjësitë e tyre ligjore. Me këtë, ato u bënë barrikada për diktatin e autokracinë e Kurtit! Këta janë luftëtarët e mbrojtjes së rendit demokratik, mbrojtës kundrejt prirjes së Qeverisë Kurti për të sunduar pavarësisht ligjit!

Në këtë frymë kundër institucioneve ende të pa kapura të drejtësisë është edhe reagimi me frymën tipike të diktatorëve, duke përmendur me emra gjyqtarët që anuluan vendimin për digjitalizimin e arkave fiskale. Ky vendim nuk është kundër vetë digjitalizimit, por kundër mënyrës së veprimit pa mbështetje ligjore. Drejtësia u gjend para një akti kur ose duhej të nënshtrohej e të devijonte nga misioni i vet, ose të vepronte sipas ligjit. Dhe ligji ka qenë gjithherë pengesë për Kurtin dhe Co., pasi që lakmitë e tyre për gjyqësi politike nuk po përmbushen dot, ndaj dhe u nisen me sulmin e hapur duke proklamuar “luftën kundër gjyqësisë” nga numri dy i pushtetit të Kurtit dhe besimin se do të triumfojnë! Si është e mundur që me kaq guxim këta që nuk janë as qeveritarë real aktualisht por vetëm në detyrë, të tregohen kaq mospërfillës ndaj ligjit dhe vendimeve të drejtësisë? Përgjigja e thjeshtë është se Kurti e Co. drejtësinë ligjore e konsiderojnë si të huaj, dhe në rastet kur është e paanshme, e

drejtë dhe legjitime, pasi që sistemi i drejtësisë nuk gjykon me dioptrinë autokratike të Kurtit. Kurti tashmë e ka vendosur veten mbi drejtësinë, ajo që e gjykon Kurti si të drejtë - ajo dhe vetëm ajo është e drejtë, kurse çdo verdikt tjetër nga organet e drejtësisë është i padrejtë dhe nuk duhet përfillur! Priirja diktatoriale e Kurtit dhe e sundimit të tij vetëm tash ka nisur të kuptohet mjaft gjerësisht, dhe kjo është shenjë e ndërgjegjësimit qytetar. Kur unë në shkrimet e mia të publikuara (në vitin 2021, 2022 e 2023) e quaja autokratik e diktaturë dhe antiamerikan (raportet e Kosovës ende janë në pikën më të ulët me SHBA) pushtetin e binomit Albin Kurti - Vjosa Osmani-Sadriu, me thoshin ca miq se e kam tepruar se nuk është ashtu. Realisht, diku thellë në veten time dëshiroja të mos kisha të drejtë, por intuita ime politike më bënte të vlerësoja ashtu. Unë nuk gëzohem që tezat e mia po dalin të vërteta, pasi që po e pëson Kosova dhe qytetarët e saj.

Ajo që binomi Kurti- Osmani-Sadriu kanë dëshmuar me konsistencë është se për të mbetur në pushtet janë të gatshëm të bëjnë gjithçka. Nuk e kanë fare gajle që ndryshojnë qëndrime, duke shpresuar se mund t’ua hedhin, sidomos amerikanëve. Kurti iu vardis presidentit Trump me disa deklarate boshe për SHBA si aleati strategjik, duke i harruar qëndrimet e tij shpesh mospërfillëse e ndonjëherë edhe hapur kundër në vitet 2021-2024, por kujtesa shtetërore amerikane është institucionale dhe mashtrimet nuk gëlltiten. Nuk mundet Kurti edhe të nëpërkëmbë me demokracinë edhe të mos koeperojë politikisht me SHBA, edhe të thotë se është me ShBA; në fakt, mundet ta thotë porse është krejt i pabesueshëm. Miqësia në politikë dëshmohet me bashkëpunim intern, koordinim dhe bashkëveprim atëherë kur duhet e kur kërkohet, e jo me fraza boshe. E presidentja që po shkëlqen me mungesë sinqeriteti. Ajo kurrë nuk është distancuar hapur prej veprimeve të Kurtit, dhe nuk ka mundur ta bëjë se kanë qenë në akordancë. Po ta kishte përnjëmend ndryshimin, pra se e ka kuptuar degradimin e demokracisë së Kosovës, ajo do të pranonte gabimin e vet që e ka mbështet Kurtin në veprimet e pakoordinuara me ShBA e edhe me KFOR-in. Ajo shpreson ta kalojë atë me heshtje duke u serviluar ndaj Shtëpisë së Bardhë. Dhe arsyeja pse nuk distancohet është se shpreson edhe në një mandat si presidente, e për këtë i duhet edhe mbështetja e Kurtit. Harron e uruara se ShBA-ja ka kujtesë institucionale, dhe as miklimet konfirmuese nuk shiten. Përderisa presidenti Trump po e përdor Kosovën për të treguar përkushtimin e tij për paqe, dhe ka kalkulime të gjeopolitikave globale, kjo e

uruara jonë deshi t’i hyjë në zemër Trumpit duke pohuar se pengimi i luftës së Serbisë ndaj Kosovës ishte i kohëve të fundit, dhe përforcoi këtë duke thënë se e ka të dhënë nga brifingjet e saja me organet e sigurisë së Kosovës! Kjo ishte një befasi për opinionin e vendit dhe nisën të ngritën pikëpyetje se përse kjo e uruara nuk paska thirrur Këshillin e Sigurisë për mobilizim dhe se si kjo si komandante supreme e FSK paska shëtitur jashtë vendit kur në rreziqe të tilla duhej të ishte në vend, në krye të detyrës. Por hutia e shua, kur Grenell, emisari i Presidentit Trump, e demantoi Presidenten duke thënë se po manipulonte me fjalët e Trumpit.

Pyetja shtrohet, kush duhet të bëjë kompromis? Elektorati ynë e ka përcaktuar këtë: i takon LV-së, pra Kurtit. Dhe Kurti e di këtë. E di se meqë nuk ka fituar si në vitin 2021, duhet kompromis, ndryshe nuk bëhet. Djallëzisht e ka gjetur momentin, duke e vënë në fokus kryekuvendarin. Ndonëse gjithçka vërtitet rreth tij e kundër tij, ai e ka nxjerrë mburojë kandidaten për kryetare te Kuvendit. Por votat nuk i ka, e megjithatë përpiqet të imponojë një kandidate që është e papranueshme nga komplet opozita. Opozita akuzohet për bllokadë, që po u zbërthye domethënë përse po e kundërshton propozimin e sundimtarit Kurti. E pikërisht këtu e ka një poenë opozita; në daç votën tonë, propozojë një tjetër kandidat. Madje janë përmendur disa emra nga AAK. Një rast i mirë do të ishte Fatmir Limaj, të cilin besoj se do ta votonin shumica e opozitës. Aq shumë kanë zgjatur negociatat mes LV-së dhe Nismës SD - sa duket sikur të ishte fjala për dy shtete të ndryshme jo dy parti të të njëjtit shtet! Opozita ka të drejtë në qëndrimet ndaj Kurtit. Ai e ka poshtëruar LDK në mandatin e parë, e në mandatin e dytë ia joshi Vjosën duke i premtuar postin e presidentes, për çka ajo nga Çavez e shndërroi në një demokrat! Do të ishte gabim fatal për LDK në kuptimin politik po të harronte këtë të kaluar të afërt, që i tregon se Kurtit kur t’i duhet për pushtet nuk heziton t’u lajkatohet e kur mos t’i duhen më - t’ua kthejë goditjet nën brez. PDK ka po ashtu arsye që të mos i besojë Kurtit. Jo vetëm sulmet e pabazuar dhe krekosjet kundër Thaçit e Veselit, thirrjet për arrestimin e tyre dhe mospërmbushja e obligimeve ndaj mbrojtjes së tyre në periudhën e sundimit të Kurtit e njëjloj edhe sot, por edhe akuzat dhe etiketimet ndaj PDK si parti - do të duhej ta bënin të mos pranojë koalicion me Kurtin! Një shans i mirë do të ishte AAK e cila mbase do të mund të pranonte koalicion me Kurtin, por aq shumë e rëndë e kanë akuzuar njerëzit e Kurtit si luftëtar dhe si politikan Ramush Haradinajn, sikur të donin me çdo kusht ta zhbënin edhe këtë

mundësi. Dhe në natën kur u shpallën rezultatet zgjedhore, fyerjet banale të Kurtit duke i quajtur partitë opozitare dhe liderët e tyre hajvanë - tregoi edhe se si i sheh Kurti të tjerët, por edhe se ashtu do t’i trajtonte po të hynin në koalicion me të. Kush e gëlltit këtë, ia paftë hajrin! Kurtit po i konvenon kjo zallahi politike sepse po dëshmon në shkallë të lartë destruktivitetin e tij ashtu sikurse e ka bërë gjithmonë.

Opozita, pra, ka të drejtë në mosbesimin ndaj Kurtit e Co. Ka të drejtë edhe në kundërshtimin e votimit të fshehtë, përmes të cilin po synohet të kontrabandohen votat e Listës serbe për Kurtin e Co. Kurti edhe po i do votat e serbëve të zgjedhur deputet, për çka dyshohet se e çoi një mësit me mision “top sekret” në Beograd, edhe ta mbaj aurorën e gjoja mosbashkëpunimit me Listën serbe. Ai ka të drejtë të bashkëpunojë me Listën serbe derisa ajo ka deputetë në Kuvend, por ta bëjë hapur. Ajo ka bashkëpunuar edhe me Radojçiqin kundër pagave të veteranëve që moralisht ka qenë bashkëpunimi më i pështirë, por që tregon se deri ku është në gjendje të shkojë bashkëpunimi i fshehtë i Kurtit me ata që janë kundër Kosovës - dhe po mos të ishte denoncimi nga mediat i këtij bashkëpunimi krejt të pamoralshëm e vërteta nuk do të merrej vesh ndoshta asnjëherë! Por opozita nuk ka aspak të drejtë që po ndjek lojën e tij, duke ia bërë të mundur ta kthejë Kuvendin e Republikës në “cirk” politik që po irriton edhe hapur aleatët e Kosovës. Kurti po bën lojën e tij, po ju, opozitë - ç’po bëni? LDK doli me një propozim, që u hodh poshtë nga të gjitha partitë. PDK doli me kërkesën se po t’i japë votat e saja LDK-ja, të tjerat i siguron. Dhe përgjigja erdhi nga Lutfi Haziri: jo 19 po 20 votat e LDK-së ia siguron PDK-së, por nuk mjaftojnë. Ky është një potez i ri politik i LDK-së. PDK-ja duhet ta kontaktojë LDK-në dhe të nisin negociata intensive. Opozita deri më tash nuk është treguar e gatshme për kompromis brenda saj. Nëse shpejt nuk del me një ujdj PDK-LDK-AAK e të cilëve do t’i bashkohej edhe Nisma e Limajt e që do t’i mernin edhe pjesën dërrmuese të votave minoritare, atëherë do të bien në provim politik ndaj shtetit, sepse nuk arrijnë të bashkohen për ta shpëtuar Republikën. Duke mos u bashkuar dhe përderisa nuk bashkohet dot opozita bie në të njëjtat pozita si Kurti e Co., ose vetvetiu tregon se e ka të njëjtën paaftësi si edhe ai. Çdo ditë që kalon, krijohen aq shumë rrethana për opozitën që të veprojnë me vizionin e shtetit, sa duket fatkeqësi se si ajo po e humb këtë mundësi për të krijuar një alternativë të besueshme për elektoratin dhe për perëndimorët!

CUBAT E KURTHIT, PJESA E PARË



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

S'mbet asgjë pa u kapur: Albin Kurthi ose është deputet për çka edhe është betuar dhe i ka votat në ndërkohë që cubqe ka uzurpuar zyrën e KM, ku sipas ligjeve në fuqi duhet të jetë Besnik Rrenc Bislimi, ZKM i parë. Cubi KM, Albin Kurthi po e keqpërdor Policinë e Kosovës duke i detyruar ta përcjellin me një eskortë prej 10 policësh, të vendosur të shtrijnë për toke çdonjërin që i afrohet cubit Kurthi në perimetrin prej 10 metrave. Cubi Albin Kurthi po i keqpërdorë maksimalisht “xhipat e zinj” duke e dërguar kudo që ia do qejfi ndonëse këtë të drejtë e kanë edhe 119 deputetë të Kuvendit të Kosovës, gjithnjë sipas ligjeve në fuqi. Cubi Albin Kurthi po i keqpërdorë mediet që i ka bërë kurvihane informative. Sikur që Tramp u akuzua se kishte paguar një prostitutë për shërbime seksuale, edhe Cubi Albin Kurthi duhet të akuzohet se ka paguar një prostitutë prej gazetari për shërbime informative. Nga 27 marsi 2025 kryecubi Albin Kurthi, bashkë me cubat dhe cubeshat e mendermethënë qeverisë, kanë marrë vendime për të cilat duhet të shkojnë në Dubravë. Pas vendimit të Gjykatës Supreme, nisi një sulm frontal i kapadaive të LV-së kundër kësaj gjykate. Mjafton që kryecubi Kurthi ta lëshojë “kushtrimin” e që trushpëlarët e tij të dalin në kor, sikur qyqet e rremit. Nuk e dinë se cili është më leshko se tjetri, janë të uniformuar në servilitetin, injorancën dhe mediokritetin e tyre. Janë pa asnjë mendim personal, pa integritet profesional, njerëzor, kombëtar dhe politik. Qeverisjen kryecubi Kurthi e ka shndërruar në diktaturë, autokraci mbi të vetët që i nënshtrohen pa asnjë kusht, pa dinjitet minimal. Këtë valëzim të diktaturës e ka shtri mbi presidencën e Kosovës përmes presidentes së Ukrainës, Vojsa Osmani. Kuvendin e ka nën këmbë përmes një të pakurrizori që po sillet si diktatorth i Kuvendit i cili nuk e respekton as moshën e

vet që ia mundësoi të terrorizojë deputetët dhe qytetarët e Kosovës, si marionetë dalë boje. Një marionetë pa dinjitet e që është pjesë e regjisë së Kurthit që nga seanca e parë, thërret regjinë t'ua ndal telefonat - mikrofonat deputetëve të opozitës. Mjerim, edhe për një marionetë. Këmbëngulin që Lenka Haxhiu të bëhet kryetare e Kuvendit përmes votimit të fshehtë sepse qenka më demokratik se ai i hapur ku Lenka mori në thua duke mos e kaluar pragun. Lenka Haxhiu thotë se nëse në votim të fshehtë nuk i merr 61 vota, do të tërhiqet nga kandidimi për kryetare të Kuvendit. Këtë e thotë edhe kryecubi Kurthi pasi i kanë siguruar 3-4 vota të Listës Serbe. Këto vota i kanë siguruar menjëherë pas zgjedhjeve, por për shkaqe “patriotike” dhe “bashkimit kombëtar” nuk i pranojnë votat e LS-së në votim të hapur. Fshehtë bënë sepse nuk dihet se kush për kë voton. Pastaj, me votim të fshehtë votat e LS-së i faturohen opozitës nga LV-ja duke bërë përpjekje ta përcajin opozitën. Si u siguruan 3-4 vota nga LS-ja? Lehtë, falë vullnetit dhe bashkëpunimit vëllazëror të Mimoza Kularit, Milan Radoiqiqit dhe Sllavko Simiqit gjatë bisedave telefonike të serialit: “Zdravo Limoza” të zemlakëve. Kryecubi Kurthi nuk do ta bëjë Kuvendin deri në kohën kur i duhet atij. Çfarë logjike ka që tash ta votojë NISMA kur ka mundur ta bëjë në fillim. Kurthi ka blerë kohë duke i bërë 100 mijë të zeza kundër Kosovës dhe shqiptarëve. Nuk ka hajn të LV-së që nuk e ka mbrojtur, pavarësisht veprave që i kanë bërë; tenderë, hajni klasike, tregti me narkotikë, kontrata njëburimore, punësim klientelist në baza partiake. Sidomos e ka kapur sistemin energjetik ku, përveç hajnavë me pedigree të Serbisë, ka punësuar edhe familjarë të ngushtë sikur edhe familjarë të bashkëpunëtorëve të ngushtë. Nëse e konsolidon diktaturën dhe

tiraninë mos u habitni që familjarët e ngushtë të cubave të LV-së të zgjidhen në krye të Gjykatës Kushtetuese, BQK-së, AKI - së dhe institucioneve tjera me rëndësi. Profesionalizmi nuk është kurrfarë kushti, mjafton librezja partiake dhe dëshmia me nënshkrim të Dejana Mihalit se janë injorantë dhe pakurrizor. Për një numër jo të vogël të tyre nuk duhet as kjo, mjafton të dëgjoni se çka flasin. Dhe si sillen. Kam kaluar një jetë me shumë peripeti, hetime, arrestime dhe burgosje por Kosova asnjëherë nuk ka pasur qeveri më antikombëtare se që e ka sot. Nëse keni ndonjë dyshim, lehtë bindeni. Merreni kabinetin qeveritar të kryecubit Kurthi 2, ministra, zv/ministra, këshilltarë dhe profil tjetër dhe do ta shihni se nuk është asnjëri me një histori kombëtare personale, ndërkaq mund të gjeni 3-4 raste që kanë trashëguar histori kombëtare, por që me sjellje antikombëtare i kanë turpëruar varret e paraardhësve të tyre dhe kujtimet për veprat e tyre. Kjo vlen edhe për deputetët e LV-së dhe bartësit e posteve tjera të larta. Ata pak patriotë në LV janë plakur, askush nuk i pyet për asgjë, i janë nënshtruar një interesi për mbijetesë dhe detyrohen t'i lexojnë pamfletet e andartes greke, Nënës së LV-së, Dezhona Mihalidis apo t'i dëgjojnë paçavurat “filozofike” të Nezir Krakovinës, nga baushella e Parisit. Ndërkaq, jam në gjendje ta bëjë një listë të gjatë të udbashëve, bijve dhe bijave të tyre, mbetjeve politike jugosllave dhe serbe që flasin shqip e që fort adhurohen nga kryecubi Kurthi, dhunues të patriotëve shqiptarë në llogoret jugosllave dhe serbe ndaj të cilëve Lenka Haxhiu nuk e ka luajtur as gishtin e vogël në ndërkohë që ka afër dëshmitarë të Hagës dhe urrejtës të pengjeve të Hagës. Edhe vet është urrejtëse e madhe e pengjeve të Hagës!

Cubat dhe cubeshat e Kurthit : 1. Dejana Mihali. Kombëtarisht është hibrid, flet shqip, mendon

greqisht, vepron serbisht. Në Shqipëri nuk zuri vend as për të pshurrur, ndërsa në Kosovë e bëri m...n e madh. E mbaj mend që nga fillimi në LV-ja sillej nëpër protesta e veshur si Baba Stana e Shumadisë. Përcillte çdo lëvizje dhe kontaktonte me shumë pak aktivistë. Ata që nuk ia dinin të kaluarën e merrnin si vajzë të Edita Mihalit ndërsa ishte bija e sigurimsit të lartë, të minoritetit grek. E filloi edukimin politik sipas metodës të Revolucionit kinez, daci - bao apo gazeta e murit ku, një kuadro e Partisë Komuniste të Kinës u mbanë ligjërata politike atyre që nuk dinë asgjë nga politika. Dejana Mihali mbante kurse për analfabetët politikë të LV-së, shkruante trakte dhe parulla kundër shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Luginës, pak edhe në Mal të Zi. Vijuesit e “Akademisë Politike antikombëtare” të Dejonës, këto mësimë i zbatuan me shumë sukses në Maqedoni të Veriut përmes VLEN-it që në një kohë rekorde i degradoi të drejtat e shqiptarëve të fituara me shumë djersë, vuajtje, burgje, luftë dhe gjak. Dejana Mihali, kryecubi Kurthi dhe VLEN i kanë futur shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në Botën serbe. Ndërkaq, zemlaku i kryecubit Kurthi në Mal të Zi, Abazoviq i ka futur shqiptarët nën thundrën ruse në Mal të Zi. Dejana ishte spiritus movens e kësaj tradhtie kombëtare. Në Luginë të Preshevës kryecubi Kurthi, një grusht shqiptarësh i ndau në masa të vogla amorfe përmes rrogëtarëve si Ardita Sinani, Shaip Kamberi dhe Baronit të ujit, Liburnit. Flamurin në luftë kundër UÇK-së, heronjve të Kombit, vlerave kombëtare, ish-të burgosurve politikë, pengjeve të Hagës dhe bashkimit kombëtar e kishte Dejana Mihali. Luftën kundër opozitës dhe kundërshtarëve politikë e bënin mashat e Dejonës, injorantë dhe mediokër të pariciklueshëm. Dejana Mihali e shndërroi RTK -në në shtëpi publike ku zbatoheshin dhe

paguhej mirë prostitucioni informativ përmes Adi Krastës, Perëndon Gërvallës dhe prostitutës tropojan. Sulmet kundër Policisë së Kosovës, gjyqësorit dhe prokurorisë së Kosovës e ka shumë për qejfi kjo mercenare antikombëtare. Nuk ka vend ku nuk i ka futur hundët për punësim dhe kapje partiake, tenderë për rrymë, diplomaci, borde, agjenci të pa-varura e ndyrësira tjera, si pjesë e kanalizimit antikombëtar. Për shkak se përbënte rrezik të madh për siguri kombëtare dhe shtetërore, ishte shpallur person i padëshiruar në Kosovë duke ia ndaluar hyrjen. Në ndërkohë antikombëtarët Kurthi, Shvarc, Sfeqla, Vojsa Osmani dhe Lenka Haxhiu, me një procedurë 48-orëshe ia njohën shtetësinë e Kosovës duke e pajisur me dokumentacion sikur të ishte çika e Isa Boletinit e jo e një udbashi grek. Kjo kësulëkuqe të cilën nuk e hanë as ujëqit e uritur të stepave të Mongolisë, LV-ja e ka shndërruar në shkollë të urrejtjes politike, njerëzore dhe kombëtare duke e sjellë Kosovën buzë falimentimit, si shtet dhe në prag të luftës qytetare. Në tërë këtë të keqe dhe fatkeqësi është një e mirë, në LV nuk ka trima, janë frikakakë që bëhen trima duke e keqpërdorur pushtetin. Kjo kësulëkuqe, me kapela të Kuqe si të Legias dhe Simatoviqit, të njëjtën ia propozoi edhe Gipit të KEDS-it për një takim sekret në LV. Kjo andarte ka bërë revolucion në punësim duke e eliminuar konkursin, është shumë i komplikuar, duke e zëvendësuar me “Whatsapp”-in, përmes një grupi që organizonte “orgji punësimi”, në krye capo dei cappi, kryecubin, Albin Kurthi. Dhe shumë të tjera. Deri sa po e shkruaj shkrimin, po lexoj se Prokuroria e Shtetit, IPK-ja dhe AKI-ja po zhvillojnë aksion kundër të dyshuarve për spiunim. E hëngre, Dejonë!

2. Cubi Besnik Rrenc Bislimi. Për shkrimin tjetër.

A ISHTE ME TË VËRTETË INGMAR BERGMANI NAZIST?

Nga: Alexander LARMAN /
The Daily Telegraph

Gjatë jetës së tij, dhe pas saj, regjisor i Ingmar Bergman është konsideruar gjerësisht si gjeni. Megjithatë, edhe gjeniut nuk i mungojnë të metat, dhe Bergmani kishte plot të tilla: pretendime (që vetë i bëri publike, përpara se të ndryshonte mendje) se kishte përdhunuar një ish-partnere; arrestimi i turpshëm për evazion fiskal dhe, më famëkeqi nga të gjitha, pretendimi se kaloi rininë si përkrahës i bindur i nazizmit dhe se kishte vajtuar vdekjen e Hitlerit.

Historia e fundit dhe më e dëmshme është rikthyer së fundmi në vëmendjen e publikut falë aktorit Stellan Skarsgård. Derisa Skarsgård morri pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Karlovi Vari, në Republikën Çeke – ku po promovonte filmin e ri të vlerësuar të Joachim Trierit, *Vlera sentimentale* [Affeksjonsverdi], në të cilin luan rolin e një regjisor i stilin e Bergmanit, me emrin Gustav Borg – atij iu bë një pyetje rreth marrëdhënies së tij me vetë Ingmar Bergmanin. (Ai kishte luajtur për të në vitet '80 të shekullit XX, në një prodhim skenik të dramës së Strindbergut, *Një lojë ëndrrë / Ett drömspel*.) Skarsgård nuk i zbuti fjalët. “Bergmani ishte manipulues. Gjatë luftës ai ishte nazist dhe është i vetmi person që njoh që ka qarë kur vdiq Hitleri. Ne vazhdimisht i gjenim justifikime, por kam ndjesinë se ai kishte një këndvështrim shumë të çuditshëm ndaj njerëzve të tjerë. Ai mendonte se disa njerëz nuk ishin të denjë. E ndjeje kur manipulonte të tjerët. Nuk ishte një njeri i mirë”.

Skarsgård e pranoi se Bergmani mbetet një artist i madh – edhe nëse jo një njeri i mirë. “Marrëdhënia ime e ndërlikuar me Bergmanin lidhet me faktin se ai nuk ishte një person i mirë”, shpjegoi ai. “Ishte një regjisor i mirë, por mund të thuash për dikë se është trap, edhe nëse është i talentuar. Caravaggio ndoshta ishte gjithashtu trap, por realizoi piktura të mëdha”.

Skarsgård nuk komentoi mbi ndonjë zbulim të ri, por megjithatë deklarata e tij kanë shkakuar njëfarë buje – jo më pak sepse Bergmani, i cili vdiq në vitin 2007, konsiderohet gjerësisht si një nga regjisorët më të rëndësishëm dhe më me ndikim të kinemasë botërore.

Që nga shpërthimi i tij në skenën ndërkombëtare në vitet '50 të shekullit XX me filmat *Buzëqeshjet* e një nate vere [Sommarnattens leende] dhe veçanërisht me veprën kryesore *Vula e shtatë* [Det sjunde inseglet] e deri te klasikë si *Britma dhe pëshpëritje* [Cries and Whispers], Fani dhe Aleksandri [Fanny och Alexander] dhe



Persona, Bergmani u bë sinonim i një kinemaje sfiduese, gjithmonë në kërkim të kufijve të rinj artistikë që tërhiqte njëherazi publikun dhe kolegët.

Martin Scorsese ka thënë se “është e pamundur të mbivlerësohet ndikimi që filmat e Bergmanit kanë pasur te njerëzit”, ndërsa Stanley Kubrick i kishte shkruar privatisht regjisorit suedez: “Vizioni yt për jetën më ka prekur thellë, shumë më thellë se çdo film tjetër që kam parë ndonjëherë. Besoj se je regjisor i më i madh që punon sot”.

Woody Allen shkoi edhe më tej, jo vetëm duke e quajtur Bergmanin “ndoshta artistin më të madh të filmit – duke marrë parasysh gjithçka – që nga shpikja e kamerës kinematografike”, por edhe duke realizuar disa filma, përfshirë *Interierët* [Interiors] dhe *Një grua tjetër* [Another Woman] që ishin ashiqare homazhe për regjisorin suedez. Filmi i tij i vitit 1982, *Një komedi seksuale e një nate vere* [A Midsummer Night's Sex Comedy] ishte një rikrijim i lirshëm i *Buzëqeshjeve* të një nate vere.

Admirimi i Allenit për Bergmanin ishte aq i madh, saqë edhe kur rishikoi me superlativa kujtimet e veta për *New York Times* në vitin 1988, nuk e pa të nevojshme të përmendte asnjë prej zbulimeve problematike. “Pamja që krijohet”, shkroi ai, “është ajo e një shpirti shumë emocional, që nuk përshtatet lehtë me jetën në këtë botë të ftohtë dhe mizore”. Megjithatë, linja partiake e idhullit të tij ishte të pranonte një flirt rinor me fashizmin, diçka që ai e kishte braktisur prej kohësh kur u bë një nga regjisorët më të respektuar në botë.

Bergmani pa për herë të parë Hitlerin kur ishte 16 vjeç, gjatë një shkëmbimi shkollor në Gjermani në vitin 1934, ku mikpritësi i tij,

Hannes – mbështetës i Rinisë Hitleriane – e çoi në një miting në Republikën e Vajmarit. I riu i impresionuar e përshkroi më vonë diktatorin si “jashtëzakonisht karizmatik ... ai e elektrizonte turmën”.

Babai i Hannesit, një klerik, ishte aq i impresionuar nga Fyreri saqë e mbushi shtëpinë me imazhe të tij dhe i dhuroi Bergmanit një fotografi të Hitlerit për ditëlindjen e tij të 17-të, “që këtë njeri ta kesh gjithmonë përpara syve”. Kur i riu suedez, që përpiquej të përshtatej me ambientin, e pyeti në cilin moment të mitingut duhej të thoshte “Heil Hitler”, pastori iu përgjigj: “Kjo konsiderohet më shumë sesa thjesht mirësjellje, i dashur Ingmar”.

Sipas vetë Bergmanit, kur u kthye në Suedi, ai ishte një “fanatik pro-gjerman”, i joshur dhe i mahnitur nga Hitleri dhe gjithçka që kishte të bënte me Nacional-Socializmin.

Fatkeqësisht, ai u gjend në një ambient të përafërt ideologjik. Babai i tij, Erik – i cili më vonë do të frymëzonte figurën e ashpër të babait në filmin *Fani dhe Aleksandri* – ishte një figurë pa asnjë pendesë nga e djathta ekstreme, që besonte se Hitleri ishte zgjidhja për problemet e botës. Siç i tha Bergmani shkrimtares Maria-Pia Boëthius në vitin 1999 – ndërsa ajo po hulumtonte për neutralitetin e pretenduar të Suedisë gjatë Luftës së Dytë Botërore – “Nazizmi që kisha parë më dukej argëtues dhe rinor. Kërcënimi i madh ishin bolshevikët, të cilët ishin të urreyer”.

Megjithëse vetë regjisor i nuk mori pjesë në veprime të hapura antisemitike, vëllai i tij, Dag, bashkë me disa miq, sulmuan shtëpinë e një burri hebre lokal, duke mbuluar muret me simbole të svastikave. (Dag më vonë arriti të bëhej diplomat i respektuar.)

Bergmani përjetoi më pas një pasojë të vogël, por tronditëse, të lidhjes së tij me Gjermaninë naziste. Kur ai vizitoi vendin, krijoi një miqësi me një vajzë lokale të quajtur Renata dhe filloi një korrespondencë me të. Por, ky letërkëmbim u ndërpre papritur kur Renata dhe familja e saj thjesht u zhdukën një ditë. Natyrisht, ata ishin hebrej.

Megjithëse Bergmani kaloi një periudhë të detyrueshme në shërbimin ushtarak në Suedi, ai nuk ka marrë pjesë në luftë. Po të kishte marrë, është e mundur që besnikëria e tij do të ishte me Gjermaninë. Ndryshe nga Dag, megjithatë, ai nuk ishte kurrë anëtar i Partisë Nacional-Socialiste Suedeze, për të cilën vëllai i tij ishte përgjegjës për ta themeluar dhe drejtuar.

Megjithatë, siç ka shkruar në kujtimet e vitit 1987, Feneri magjik [Skiptikon], “për shumë vite, isha në anën e Hitlerit, i kënaqur nga sukseset e tij dhe i trishtuar nga disfatat”. Zgjimi i vërtetë për të erdhi pak pas përfundimit të luftës dhe rrëzimit të regjimit të Hitlerit. “Kur u hapën dyert e kampeve të përqendrimit, fillimisht nuk doja të besoja atë që shihja”, tha ai më vonë. “Kur doli e vërteta, ishte një tronditje e tmerrshme për mua. Në mënyrë brutale dhe të dhunshme, u çrrënjosa papritur nga pafajësia ime”.

Ata që kanë tentuar të justifikojnë marrëzitë e rinisë së Bergmanit, argumentojnë se megjithëse ai nuk e mohoi plotësisht Hitlerin dhe nazizmin deri në vitin 1946 – kur kuptoi se çfarë e kishte mahnitur – ajo përballje ishte një tronditje e thellë që i ndryshoi rrjedhën e jetës dhe karrierës. Siç i tha mikut dhe producentit të tij, Jörn Donner: “Ndjenjat e mia ishin dërrmuese dhe ndjeva hidhërim të madh ndaj babait tim, vëllait dhe mësuesve të shkollës dhe të gjithë të tjerëve që



më kishin çuar drejt asaj rruge. Por, ishte e pamundur të shpëtoja nga faji dhe përbuzja për veten”.

Pas kësaj, shumë nga filmat dhe produksionet e tij teatrale trajtonin në mënyrë të drejtpërdrejtë të keqen e shkakuar nga regjimi nazist – qoftë përmes filmit në anglisht, *Veza e gjarprit* [The Serpent's Egg, 1977], ngjarja e të cilit zhvillohet në Berlinin e vitit 1932, apo përmes vendimit për të vënë në skenë në Stokholm dramën *Hetimi* [Die Ermittlung] të Peter Weissit, për gjyqet e Aushvicit, në vitin 1966.

Disa nga filmat më të vlerësuar të tij e trajtojnë këtë temë në mënyrë më të tërthortë, përmes ndjenjës së fajit dhe mungesës së komunikimit të shkakuar nga konfliktet – përfshirë *Heshtjen* [Tystnaden, 1963], që ndjek udhëtimin e dy motrave dhe që u frymëzua nga qëndrimi i Bergmanit në Gjermani pas luftës; si dhe *Turpi* [Skammen, 1968], ku një martesë, dhe një vend pa emër, shkatërrohen nga një luftë civile.

Do të ishte e rëndësishme t'i nxirrnim në pah këta filma si një kërkimfajle të drejtpërdrejtë për besimet e tij të hershme – të cilat, në çdo rast, nuk ishin të njohura gjerësisht deri në botimin e kujtimeve – por, nuk ka dyshim se ato ndikuan tek ai.

Gjithashtu do të ishte gabim të merrje deklarata të Bergmanit fjalë për fjalë. Siç tha në vitin 2019, Jane Magnusson, regjisore e dokumentarit *Bergmani*: Një vit në jetë [Bergman – ett år, ett liv]: “Fakti që ai kishte simpati për Hitlerin ... ai donte të fliste për këtë. Dhe, askush tjetër nuk donte. Ai ishte thuajse i vetmi në Suedi kur, në vitet '80 të shekullit, doli hapur dhe tha: ‘Shkova në Gjermani, isha në Vajmar gjatë paradës dhe bërtita ‘Heil Hitler’! Dhe, më pëlqeu kjo”.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova - Zvicra sot përballen në çerekfinale të Evropianit

Pas përfundimit të garave në grupe janë përcaktuar çiftet e çerekfinale në FIBA U20 Kampionatit Evropian, Divizioni B. Dardanët e rinj për herë të parë depërtuan në mesin e tetë më të mirëve.

Kosova kishte tri fitore e një humbje, duke përfunduar e dyta në Grupin D pas Turqisë. Pikërisht ndaj kësaj të fundit pësuan humbjen e vetme që erdhi pas tri fitoreve radhazi, ndaj Suedisë, Shqipërisë dhe

Hungarisë. Dardanët në çerekfinale do të përballen me Zvicrën. Zvicra ishte e para në Grupin C, edhe pse kishte tri fitore e dy humbje, por me koshdallim më të mirë, pasi edhe Holanda,

Austria e Danimarka kishin nga tri fitore e dy humbje. Takimi do të zhvillohet të premten, derisa ora do të përcaktohet më vonë. Fituesi i ndeshjes Kosova - Zvicra në gjysmëfinale përballlet me

fituesin e ndeshjes Letonia - Britania e Madhe. Kjo është hera e parë që Kosova U20 hyri në mesin e tetë më të mirave. Njëkohësisht suksesi më i madh te gjeneratat e reja.

DARKO PREBIRAÇEVIÇ, TRAJNERI I RI I KOSOVËS NË VOLEJBOLL



“Epoka e re”

PRISHTINË, 17 KORRIK - Federata e Volejbollit e Kosovës e ka zyrtarizuar të enjten marrëveshjen me trajnerin e njohur malazez Darko Prebiračević i cili do ta udhëheqë Përfaqësuesen A të meshkujve për një periudhë njëvjeçare në kuadër të projektit të mbështetur nga Federata Ndërkombëtare e Volejbollit (FIVB). Marrëveshja u nënshkrua në ambientet e Federatës së Volejbollit të Kosovës në prani të presidentit të FVK-së, Bahri Gjinovci dhe sekretarit të

përgjithshëm Valon Nikqi. “Përveç angazhimit në Përfaqësuesen A, trajneri Prebiračević do të përfshihet edhe në zhvillimin e ekipeve të tjera kombëtare të grupmohave, në vazhden e projektit të nisur me mbështetjen e FIVB për ngritjen e volejbollit kosovar në të gjitha nivelet. Prebiračević është trajneri i dytë i huaj që angazhohet në drejtimin e Kosovës pas çekut Martin Nemec, i cili e udhëhoqi ekipin së fundmi”, thuhet në njoftimin e FVK-së. Përvoja e Prebiračević është e pasur dhe përfshin angazhime si ndihmëstrajner i kombëtares së të rriturve të Malit të Zi në evente të

rëndësishme ndërkombëtare si Liga Botërore 2017, Kampionati Botëror FIVB 2018, EuroVolley 2019, 2021 dhe 2023, si dhe Lojërat e Shteteve të Vogla ku fitoi medaljen e artë në vitin 2019. Po ashtu, ai ka qenë trajner kryesor i ekipeve të moshave të Malit të Zi në garat ballkanike dhe evropiane. Në nivel klubesh ka arritur suksese të shumta me ekipin Jedinstvo Bemax në Mal të Zi dhe ka pasur një periudhë të suksesshme edhe në Katar me ekipin Qatar Sport Club, me të cilin arriti gjysmëfinalen e Kupës së Emirit dhe vendin e katërt në kampionat në sezonin 2024/25.

SHKURT

Mota nga FC Porto përforcon Prishtinën

FC Prishtina e ka paraqitur transferimin më të ri. Bëhet fjalë për sulmuesin Lusi Mota i cili në kryeqytetin e Kosovës vjen nga FC Porto. “Luis Mota është përforcimi ynë më i ri që i bashkohet ekipit për sezonin e ri. Mota është sulmues portugez, 21-vjeçar me përvojë në strukturat e klubit FC Porto (B), dhe sjell cilësi teknike, shpejtësi si dhe instinkt goli që pritet ta ndihmojë skuadrën tonë në fazën ofensive. Mota, po ashtu, ka qenë pjesë e skuadrës së Beleneses”, thuhet në njoftimin e Prishtinës. Ky transferim tregon ambiciet e FC Prishtinës për të ndërtuar një skuadër konkurruese jo vetëm në nivel vendor, por edhe në garat ndërkombëtare. “Jam shumë i lumtur për këtë transferim dhe mundësinë që ta përfaqësoj një klub të madh si Prishtina. Falënderoj udhëheqësin e klubit për besimin që ma kanë dhënë dhe jam i bindur që së bashku do të arrijmë suksese”, ka thënë Mota.

Leverkuseni refuzon ofertën e parë të Neom SC për Xhakën

Bayer Leverkuseni ka refuzuar një ofertë prej 8 milionë eurosh nga Neom SC për Granit Xhakën, raporton “Sport Bild”. Në negociatat në vazhdim mes klubit saudit dhe klubit gjerman të Bundesligës, gjithsesi mund të jetë vetëm çështje kohe para se transferimi të konkretizohet. Neom i ka ofruar Xhakës një pagë shumë të majme dhe Leverkuseni është bërë më i hapur ndaj mundësisë që 32-vjeçari të largohet. “Kicker” raportoi kohët e fundit se drejtuesit e Leverkusenit besojnë se Aleiks Garsia dhe Robert Andriç mund ta kompensojnë në mënyrë efektive mungesën e Xhakës në këtë repart. Klubi gjerman tani kërkon 20 milionë euro për Xhakën, çka bie ndesh me raportimet e mëparshme që sugjerorin një vlerësim prej 8 deri në 15 milionë eurosh për veteranin zviceran. Gjithsesi, Neom përsëri mund ta përballojë financiarisht marrëveshjen.

Berisha pas tetë vjetësh e gjysmë largohet nga Akhmat Grozny

GROZNY, 17 KORRIK - Bernard Berisha nuk është më pjesë e Akhmat Groznyt. Futbollisti nga Kosova i ka ndarë rrugët me klubin rus pas më shumë se tetë vjetësh. Lajmi nga klubi nga liga elitare e futbollit rus, e cila e ka falënderuar përfaqësuesin për kontributin dhe i ka uruar atij suksese në të ardhmen. “Pas tetë vjetësh e gjysmë punë, Bernard Berisha po largohet

nga klubi i Groznyt. Palët e arritën një marrëveshje për ta ndërprerë kontratën me pëlqim të ndërsjellë. Berisha u bë një legjendë e Akhamatit pasi i zhvilloi 199 ndeshje për klubin në ndeshje zyrtare, në të cilat i shënoi 28 gola dhe i bëri 23 asistime”, shkroi fillimisht klubi nga Grozny në faqen zyrtare në rrjetet sociale. “Bernardi la gjurmë të ndritshme në historinë e klubit tonë. Një

profesionist i vërtetë në fushë, një lider, i sjellshëm dhe i përgjegjshëm në jetë - kështu do të mbahet në mend mesfushori nga tifozët, për të cilët Bernardi është bërë një i preferuar dhe një idhull gjatë këtyre viteve. Faleminderit për vëllazërinë dhe miqësinë burrërore me secilin prej ekipit tonë! Paç fat, vëlla!”, përfundon njoftimi i Akhamatit.



Fitorja është synim i vetëm i Kosovës ndaj Izraelit

PRISHTINË, 17 KORRIK - Pas paraqitjes pozitive në fazën grupore, Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll të premtën e luan ndeshjen e parë për plasman përfundimtar në Kampionatin Evropian në Gjeorgji. Vajzat e Kosovës luajnë për plasman prej pozitës së pestë deri në

pozitën e tetë. Nga ora 10:45 është ndeshja me Izraelin, në të cilën synimi i vetëm i Kosovës është fitorja. Izraeli në fazën grupore e kishte një fitore e tri humbje, ndërsa Kosova i kishte dy fitore e dy humbje. Për plasman prej vendit të pestë deri në vendin e tetë garojnë edhe Luksemburgu dhe

Britania e Madhe. Ndeshjet përfundimtare janë të dielën. Fazën e parë Kosova e përfundoi në vendin e pestë prej dhjetë kombëtareve sa janë në Evropianin B. Synohen edhe dy fitore të tjera për plasmanin më të mirë të deritashëm në kampionate evropiane. Vajzat e reja

“dardane” fituan bindshëm ndaj Bullgarisë dhe Gjeorgjisë, ndërsa pësuan nga Ukraina dhe Sllovakia. Në fakt, vetëm pjesë e dytë e ndeshjes me Ukrainën ishte nën nivelin e pritur. Pjesa e parë e asaj ndeshjeje ishte plotësisht e barabartë. Me Sllovakinë, që është favorite për triumf, vajzat tona



luajtën ndeshje të fortë dhe plotësisht të barabartë nga fillimi e deri në fund. Vetëm në minutat e fundit Sllovakia u shkëput në rezultat për fitore 26:22.

Marquezi për pajtimin me Rossin: Nuk varet vetëm nga unë

CERVERA, 17 KORRIK - Me 200 garat e tij në Moto GP të kurorëzuara me festën në triumfin në Gjermani, Marc Marquez ka analizuar karrierën e tij në një intervistë për “DAZN”. Piloti spanjoll flet për pjesën më të madhe të karrierës së tij në kategorinë kryesore të Motoçiklizmit Botëror, duke u përqendruar në secilën prej figurave që përbëjnë trashëgiminë e tij, si dhe marrëdhënien që ka pasur me disa nga rivalët më të mëdhenj që nga debutimi në vitin 2013. Disa rivalë kanë lënë ndikim tek ai gjatë fazave të ndryshme të karrierës, por askush më shumë se Dani Pedrosa. “Mësova shumë prej tij kur e kisha shok të ekipit. Pedrosa është ai që më mësoi më shumë se si të drejtoj në Moto GP. U përpoqa të drejtoj si ai, por me më shumë forcë dhe pak më agresivisht”, ka thënë Marquez. Nga ana tjetër, “armiçësia” me Valentino Rossin vazhdon ende. Megjithatë, ish-kampioni italian mbetet rivali me të cilin ai është lidhur më ngushtë. “Doktori” kaloi nga ta quajturit Marc Marquezin si një version i përmirësuar i vetes në



përkufizimin e tij si një pilot i rrezikshëm për sportin. Ftohja mes dy pilotëve filloi në fund të sezonit 2015, kur italiani akuzoi “93”-shin për ndihmën që i dha Jorge Lorencos për ta fituar Kampionatin Botëror, deri në Çmimin e Madh të San Marinos 2018, kur piloti i atëhershëm i Yamahas refuzoi t'i shtrëngonte dorën rivalit spanjoll në konferencën për shtyp. Kur u pyet nëse për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tij me Valentinon, ai u përgjigj drejtpërdrejt dhe shkurt: “Kur diçka nuk varet vetëm nga një person, nuk mund të thuash, nuk jam i interesuar, jo”, duke përjashtuar çdo mundësi pajtimi mes dy prej pilotëve më të mëdhenj të të gjitha kohëve. Marquez këmbëngul se ai kurrë nuk ka qenë veçanërisht i

përqendruar te numrat në karrierën e tij. “Gjatë gjithë karrierës sime nuk jam fokusuar asnjëherë te numrat dhe statistikat. Nuk e dija sa fitore kishte Agostini apo Valentino”, shpjegon 32-vjeçari i Ducatit. Megjithatë, Markezi thekson se numri i 89 fitoreve të Rosit në Moto GP është një numër që ai e sheh si “të vështirë” për t'u barazuar, teksa aktualisht “Kanibali” numëron 69 triumfe në klasën mbretërore. Megjithatë, nga ana tjetër ai pranon se barazimi i 7 kampionateve botërore të italianit në Moto GP mund të jetë më i realizueshëm, veçanërisht këtë sezon, me pilotin e Ducatit që po dominon totalisht, duke kryesuar me një epërsi prej 83 pikësh ndaj vendit të dytë, që mbahet nga vëllai i tij, Aleks Markez. Kështu, pas triumfit në Sachsenring të dielën e kaluar, Marc Marquez është 20 fitore pas Rossit, si piloti më i suksesshëm në historinë e Moto GP-së. Me 11 gara të mbetura në sezonin aktual dhe superfuqinë e Ducatit, Marc Marquez mbetet në radhën e parë të nisjes për të vendosur rekorde të tjera në Moto GP.

Piastri: Jo vetëm Norris për titull, Verstappen ka përvojën për të na vënë në vështirësi në çdo garë

WOKING, 17 KORRIK - Edhe pse duket se gara për titullin kampion për pilotë do të jetë një garë dyshe mes dy pilotëve të McLaren, Oscar Piastri e Lando Norris, piloti australian ka dyshime për këtë gjë. Ai beson se edhe Max Verstappen do të duelojë deri në fund pavarësisht prej problemeve që ka Red Bull. Oscar Piastri ndodhet tetë pikë përpara Lando Norris dhe 69 përpara Verstappenin në renditje. Kryesuesi i Botërorit beson se kampionati do të jetë i hapur deri në fund, ndaj ai nuk e përjashton 4 herë



kampionin e botës në Formula 1 nga gara për titull. “Rivaliteti nuk më shpërqendron dhe sa i përket kampionatit, nuk jam shumë i shqetësuar për atë që po bën Max ose sa pikë është pas meje. Mendoj

se ai do të jetë një kërcënim çdo fundjavë ose shumicën e fundjavave. Ndaj kjo është arsyeja pse nuk mund ta përjashtosh nga gara për titull”, ka thënë Piastri. “Nuk e dimë nëse makina ka ritmin e duhur apo jo. Çdo fundjavë përpiqem të bëj më të mirën dhe shqetësohem për këtë. Kështu që, nuk shqetësohem për pozicionin e Maxit në kampionat. Natyrisht, ai është pak më prapa tani. Është një epërsi e mirë për t'u kompensuar, por nuk shqetësohem shumë”, ka deklaruar australianin.

Real i bën gati 100 milionë euro për Enzo Fernandezin

Real Madridi është vënë në kërkim të një mesfushori të ri dhe për ta plotësuar dëshirën e madhe të Xabi Alonsos, klubi madrilen është i gatshëm të shpenzojë 100 milionë euro. Edhe pse janë përmendur

emra si Vitinha, Nicolò Barrella apo edhe Alexis Mac Allister, dëshira kryesore e Xabi Alonsos është argjentinas i Chelseas: Enzo Fernandez. Megjithatë, rruga për të arritur deri tek ai është

shumë e gjatë. Së pari duhet një ofertë bindëse për Chelsean që të heqë dorë nga një lojtar kyç, për të cilin u paguan 120 milionë euro te Benfica. Së dyti, Real duhet ta krijojë hapësirën e nevojshme

në ekip, lidhur edhe me pagat, ndaj para se të vijë Enzo Fernandez, duhen bërë disa largime. Në listë janë disa emra për t'u larguar si Rodrygo, Eduardo Camavinga, të cilët kanë çmim të madh në

treg dhe rroga të majme. Pastaj vijnë emra të tjerë si Dani Ceballos, Fran Garcia etj. të cilët vlejnë më pak, por pa bërë shitjet e duhura, duket i vështirë transferimi i Enzo Fernandezit.

SHKURT

Sot hidhet shorti për edicionin e ri të futbollit në Shqipëri

Federata e Futbollit do të organizojë sot (e premte) hedhjen e shortit për kalendarin e edicionit të ri të “Kategoria Superiore 2025-2026”. Departamenti i Komunikimit i FShF-së bën me dije se shorti për edicionin e 87 të kampionatit “Kategoria Superiore” dhe për kampionatin e Kategorisë së Parë do të hidhet në ambientet e “Shtëpisë së Futbollit” nga ora 11:00. Kampionati “Kategoria Superiore” do të nisë më 23 gusht 2025 dhe është planifikuar të përfundojë në muajin maj 2026. Në kampionatin “Abissnet Superiore” këtë sezon do të marrin pjesë këto skuadra: KF Egnatia, KF Vllaznia, FC Dinamo City, KF Partizani, AF Elbasani, KF Teuta, FK Bylis, KF Tirana, FK Vora dhe KF Flamurtari.

Usyk dhe Dubois sfidohen për titullin kampion të peshave të rënda

Londër, 17 korrik - Daniel Dubois ka deklaruar se do të “sjellë kaos” kundër Oleksandr Usyk të shtunën, ashtu siç bëri në fitoren e tij ndaj Anthony Joshuas në shtator. Usyk dhe Dubois u përballën për herë të parë në një takim intensiv ballë për ballë në shkallët e stadiumit “Wembley” të martën, për ta nisur ndërtimin e atmosferës për duelin e tyre për titullin në peshat e rënda. Tensionet u rritën kur të dy boksierët u përballën për herë të parë, të rrethuar nga ekipet e tyre, mediet dhe publiku. Nga ekipi ukrainas u dëgjuan brohoritje “USYK, USYK”, ndërsa një anëtar i ekipit të Dubois bërtiti “Mirë se erdhe në Angli” dhe “Tani jemi në Londër, jo në Poloni”, duke iu referuar ndeshjes së parë mes tyre në Wrocław në vitin 2023, të cilën Usyk e fitoi me nokaut në raundin e nëntë. Dubois bërtiti “Jam kampioni i ri” në fytyrën e kundërshtarit të tij, ndërsa synon të bëhet kampioni i ri i padiskutueshëm në peshat e rënda. Dubois është i bindur se mund ta bëjë ndaj Usyikut të njëjtën gjë që bëri ndaj Joshuas në të njëjtin vend në shtator, kur e rrëzoi atë tri herë përpara se ta nokautonte brutalisht në raundin e pestë.

Yamal pasi mori numrin 10 te Barça: Asnjë presion, tani është radha ime

Barcelona ka zyrtarizuar një nga momentet më emocionuese të verës: Lamine Yamal, supertalenti 18-vjeçar, ka rinovuar deri më 2031 dhe do ta mbajë fanellën më të shenjtë të klubit - numrin 10, trashëgimi e Messit, Ronaldinhos dhe Maradonës. I qetë dhe plot besim, Yamal i ka mahnitur tifozët me fjalët para medieve: “Numri 10? Asnjë presion. Messi hapi rrugën me numrin 10, tani është radha ime. Çdo fëmijë ëndërron të ketë diçka nga Messi, Ronaldinho dhe Maradona. Do të përpiqem ta vazhdoj trashëgiminë e tyre”. Me emocion dhe përulësi, Lamine theksoi lidhjen e tij të thellë me klubin që e ka rritur: “Barça është jeta ime, jam këtu që kur isha 7 vjeç. Kjo është shtëpia ime, dhe unë do të vazhdoj të punoj. Është ëndrra ime. Do të argëtohem në ‘Camp Nou’”.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Kosmonte Foods” shpk, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Thertoren e Shpezëve – Pulave, në Z.K. Harilaç, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 01.09.2025 në ora 10:00 në Objektin e SHFMU “Bajram Curri” Sllatin e Madhe, Fushë Kosovë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Kosmonte Foods” shpk, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Kosmonte Foods” shpk, Fushë Kosovë, për Pëlqim Mjedisor, – për Thertoren e Shpezëve – Pulave, në Z.K. Harilaç, Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Ro-Bin Stone”shpk, Klinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Impantin e Përpunimit, Thërrmimit dhe Seperimit të Gurit Gëlqeror, në Dresnik, Klinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.08.2025 në ora 11:00 në Objektin e SHFMU “Zgjimi Gremnik”, në fshatin Gremnik, Klinë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Ro-Bin Stone” shpk, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Ro-Bin Stone”shpk, Klinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Impantin e Përpunimit, Thërrmimit dhe Seperimit të Gurit Gëlqeror, në Dresnik, Klinë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “MA.CON” shpk, Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Përpunimin, Thërrmimin dhe Seperimin e Gurit Gëlqeror- Rritja e Kapacitetit, Linja 1 dhe Linja 2, në Z.K. Cerrcë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.08.2025 në ora 14:00 në Objektin e SHFMU “Bajram Curri” në Cerrcë, Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania “MA.CON” shpk, Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “MA.CON” shpk, Istog, për Pëlqim Mjedisor, – për Përpunimin, Thërrmimin dhe Seperimin e Gurit Gëlqeror- Rritja e Kapacitetit, Linja 1 dhe Linja 2, në Z.K. Cerrcë, Istog.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Rubini Corp” shpk, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Vendosjen e Seperacionit për Seperimin e Shkëmbit Gëlqeror të Mermerizuar, në Z.K. Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.09.2025 në ora 10:00 në Objektin e SHFMU “Tre Dëshmoirët”, në fshatin Zatriq, Rahovec, do të organizohet debat publik nga Kompania “Rubini Corp” shpk, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Rubini Corp” shpk, Fushë Kosovë, për Pëlqim Mjedisor, – për Vendosjen e Seperacionit për Seperimin e Shkëmbit Gëlqeror të Mermerizuar, në Z.K. Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh . A .Pejë me datë 18.07.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Kontroller i brendshëm (Inspektor) - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.5

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Obligohet që në terren të sillet korrekt dhe të mbajë uniformë dhe shenjë identifikimi të Ndërmarrjes.
- Në baza ditore merr urdhëra nga udhëheqësi i inspektorëve për ankesat dhe kërkesat që duhet inspektuar , angazhohet drejtpërdrejt me rastin e zgjedhjes së ankesave dhe është përgjegjës për dhënien e shenimeve të duhura për zgjidhjen e këtyre kontesteve në afat sa më të shpejtë.
- Raporton tek udhëheqësi i inspektorëve të gjitha proqeset që i ka inspektuar sipas rregullores së punës.
- Jep përgjegjësi për moskryerjen e ankesave që i janë deleguar nga udhëheqësi i inspektorëve.
- Sipas planit mujor të udhëheqësit të inspektorëve, bën inspektimin, monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të inksasantëve në terren se a është bërë dorëzimi i faturave të konsumatorët dhe kontrollon se a janë të gjitha faturat në rregull.
- Kontrollerët e brendshëm duhet të verifikojn në vazhdimsi listat e klientëve në teren dhe të bëjnë përditësimin e të dhënave të klientëve ekzistus, regjistrimin e klientëve të rinjë.
- Kontrollerët e brendshëm duhet të inspektojnë kryerjen e punëve në terren mbi shërbimin e mbeturinave dhe të raportojnë për gjetjet të udhëheqësi i inspektorëve.
- Kontrollerët, në bazë të kontrollimit të gjendjes reale dhe të gjetjeve në terren, raportojnë tek udhëheqësi i inspektorëve me shkrim.
- Raporton punën ditore , mujore dhe vjctore te udhëheqësi i inspektorve.
- Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore.
- Kryen edhe punë të tjera operative me urdhëresë të udhëheqësit të inspektorëve.
- Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

- a. Kushtet e përgjithshme :
- CV;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
 - Letër motivimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

- b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)
- Shkolla e Mesme , e preferuar Diplom Universitare ;
 - Njohja e punës me kompjuter ;
 - Aftësia të mira komunikimi;
 - 1 vit përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Pozita : Ngasës i Automjeteve Komeriale (kamionit) - 3 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Drejton automjetin, kujdeset për rregullsinë e tij dhe është përgjegjës për ngasjen e sigurtë, duke i respektuar rregullat trafikut rrugor dhe të sigurisë.
- Kujdeset për higjenën dhe pastërtinë e automjetit, si dhe para çdo ndezje të automjetit kontrollon gjithëmbarshtëm çdo pajisje dhe cep të automjetit dhe në momentin që vëren problem mekanik apo elektrik lajmëron kryepunëtorin, dhe nëse prishja ka ditë që nuk është rregulluar, lajmëron dhe MO, KE për problemin elektrik apo mekanik.
- Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga kryepunëtori dhe koordinatori operativ në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve.
- Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për fikjen zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion.
- Çdo ndalje për mbledhjen e mbeturinës është i obliguar që ta bëjë sigurtë dhe mundësisht në skajin e rrugës ose jashtë rrugës. Gjatë lëvizjes prapa dhe gjatë marrjes së mbeturinave me shpejtësi të vogël është i detyruar të lëshojë 4 treguesit e drejtimit dhe çdo herë për çdo veprim në trafik rrugor të jetë i sigurtë se ai veprim do të bëhet pa shkakuar incident.
- Duhet të pajisjet me certifikatë të rregullt shëndetësore për ngasje të automjetit dhe e njëjta të jetë valide.
- Nuk duhet të konsumojë duhan, alkool, apo narkotikë përgjatë drejtimit të automjetit, si dhe barëra të cilat kanë shenjë në trekëndëshit të sigurisë me ngjyrë të kuqe në vend të dukshëm.
- Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit, Kordinatorit Operativ.
- Është i obliguar të menaxhoi dhe të mbaj nën kontroll ekipin e punëtorëve fizik.
- Ështe i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe PPM (pajisjet personale mbrojtëse).
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit.
- Për mosrespektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

- a. Kushtet e përgjithshme :
- CV;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
 - Letër motivimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

- b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)
- Përgatitje profesionale – Shkollim të mesëm, kategori përkatëse (C1-C);
 - Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Pozita : Punëtor fizik në mbledhjen e mbeturinave - 8 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.2

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave;
- Mbledh mbeturinat dhe bën zbrazjen e kontejnerëve dhe mjeteve të tjera për hedhurina apo qeseve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror;

- Pas zbrazjes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdes;
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve;
- Ështe i obliguar të mbaj uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë (PPM);
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të shoferit dhe kryepunëtorit;
- Për mos respektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet drjtëpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv

- a. Kushtet e përgjithshme :
- CV;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
 - Letër motivimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.
- b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)
- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillor;
 - Aftësi fizike dhe psikike të dëshmuar;
 - Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë

Mënyra e Aplikimit : Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 18.07.2025 deri me 04.08.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Burim Grezda shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.
- Elona Gjocaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, dhe certifikatën e maturës.
- ARBNORA HALITI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.
- LEUTRIM ZYMERI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.
- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.
- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.
- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurta. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

